

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Nëntor, 2006 Nr. 14

GRUPI NEGOCIATOR RAPORTOI PËR PROCESIN E BISEDIMEVE PËR STATUSIN E KOSOVËS

Të drejta të garantuara për pakicat, por jo ndarje në baza etnike



*Dokument themelor për angazhimet e Grupit Negociator në procesin e statusit gjithnjë duhet të jetë Rezoluta për Rikonfirmimin e Vullnetit të Popullit për Pavarësi dhe Shtet Sovran e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës
Bëhen vërejtje në disa zgjidhje të propozuara rreth decentralizimit dhe zonave mbrojtëse të manastireve serbe*

UNMIK-u mbështet plotësisht qëndrimin e Grupit të Kontaktit për Kosovën

*Lavdërohet puna që po bëjnë anëtarët e
këtij grupi në terren për t'i sqaruar
qytetarët për procesin negociator
Përkushtim i lartë i institucioneve të vendit
për plotësimin e standardeve për Kosovën*



Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kolë Berisha ka pritur sot zëvendëskryeadministratorin Stiven Shuk dhe ka biseduar me të për vazhdimin e procesit negociator për përcaktimin e statusit të Kosovës.

Kreu i legjislativit të vendit ka theksuar përkushtimin i institucioneve për t'i zgjidhur problemet dhe përfunduar me sukses procesin negociator për statusin, “natyrisht me ndihmën e miqve tanë, në radhë të parë ata amerikanë”, ka thënë Berisha.

Duke folur për punën që po bëhet për plotësimin e standardeve, kryeparlamentari Berisha e ka njoftuar zëvendësshefin e UNMIK-ut se në seancën e ardhshme, më 9 tetor, Kuvendi do ta miratojë Ligjin për Trashëgiminë kulturore. Berisha, ndërkaq, ka tërhequr vëmendjen se deklaratat për mundësinë e shtyrjes së statusit të Kosovës, ngado që vijnë, nuk i shërbejnë zgjidhjes së problemit, përkundrazi. Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, z. Stiven Shuk, ka vlerësuar punën e institucioneve të Kosovës për plotësimin e standardeve, që nga publikimi i Raportit të Kai Eides, këtu e një vit më parë. Ai ka vlerësuar angazhimin e Grupit Negociator të Kosovës për përcaktimin e statusit të vendit dhe ka lavdëruar punën që po bëjnë anëtarët e këtij grupi në terren për t'i sqaruar qytetarët për procesin negociator. Shuk ka inkurajuar takimet e tilla me qytetarë dhe vazhdimin e bisedimeve për çështjet teknike, në mënyrë që zgjidhja e çështjes së statusit të përfundojë sa më shpejt. Në këtë vështrim ai ka pohuar se UNMIK-u mbështet plotësisht qëndrimin e Grupit të Kontaktit për Kosovën dhe ka premtuar ndihmën për mbarëvajtjen e procesit negociator.



PËRMBAJTTJA:

Vendime me konsensus të plotë të anëtarëve të Ekipit të Unitetit	3
Slovenia - urë lidhëse ndërmjet Kosovës dhe Unionit Evropian	11
Parlamentarët e NATO-s vlerësojnë progresin e arritur në vend	14
Pastrimi i parave është një materie komplekse me dimensione globale	17
Prona private nuk është vetëm në funksion të individit	20

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: **038 211 188**

E-mail:

media@assembly-kosova.org

Web faqja:

www.assembly-kosova.org

Të drejta të garantuara për pakicat, por jo ndarje në baza etnike

Dokument themelor për angazhimet e Grupit Negociator në procesin e statusit gjithnjë duhet të jetë Rezoluta për Rikonfirmimin e Vullnetit të Popullit për Pavarësi dhe Shtet Sovran e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës
Bëhen vërejtje në disa zgjidhje të propozuara rreth decentralizimit dhe zonave mbrojtëse të manastireve serbe
Shefi i Grupit Negociator dhe anëtarët e këtij grupi në fund të debatit çmuan lart angazhimin e deputetëve në këtë seancë, duke vlerësuar se këto angazhime do të jenë ndihmesë e madhe për aktivitetin e mëtejshëm të këtij delegacioni



Raportimi i Grupit Negociator për ecurinë e bisedimeve për statusin e Kosovës ishte pikë e vetme e rendit të ditës së seancës së sotme plenare të Kuvendit të Kosovës, si vazhdim i seancës së 1 shtatorit, e drejtuar nga Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit. Në fillim të seancës deputetëve iu drejtua kryeparlamentari Berisha duke theksuar se në procesin e negociatave është e angazhuar një armatë

e tërë njerëzish, të cilët në forma dhe në cilësi të ndryshme, qoftë si grup politik-strategjik, qoftë si pushtet lokal, qoftë si ekspertë të fushave të caktuara, qoftë edhe si përfaqësues të Këshillit Konsultativ me minoritetet, janë angazhuar dhe kanë dhënë kontributin e tyre në këto bisedime. Në vazhdim ai tha se nuk kemi nënshkruar asgjë, nuk kemi vulosur asgjë. Në vijim ai citoi këto fjalë nga një paragraf i dokumentit të

parë që i është dhënë z. Ahtisari, ku thuhet: “Delegacioni i Kosovës u qaset bisedimeve për reformën e pushtetit lokal duke u mbështetur në qëndrimin se, nuk mund të ketë marrëveshje për asnjë element të pakos për zgjidhjen e statusit përfundimtar, përderisa të mos arrihet marrëveshja për pakon në tërësi”. Kemi refuzuar dhe do të vazhdojmë të refuzojmë çdo kërkesë e cila do ta cenonte integritetin territorial dhe politik të

Kosovës dhe përcaktimin tonë për pavarësinë e Kosovës, pavarësisht se nga kush vjen”. Kryeparlamentari Berisha në vijim ftoi deputetët për qasje konstruktive gjatë debatit.

Gjatë debatit të sotëm pjesa dërmuese e diskutuesëve përkrahën Grupin Negociator, por ata shprehën edhe mjaft shqetësime lidhur me disa zgjidhje të propozuara në procesin e decentralizimit, që kanë të bëjnë me komunat një etnike, sidomos me tendencat të ndarjes etnike, të ushtrimit të pushtetit, të grupimit horizontal, si dhe të ndërlidhjes vertikale me Serbinë, që do të reflektoheshin negativisht në të ardhmen e Kosovës, sidomos në funksionalitetin e shtetit të Kosovës. Po kështu deputetët bënë shumë vërejtje edhe rreth zgjidhjeve të propozuara kur është fjala për zonat mbrojtëse të manastireve serbe.

Deputetët angazhoheshin për Kosovë të pavarur, me sovranitet të plotë në tërë territorin e saj, me ulëse në OKB dhe të integruar në institucionet euroatlantike, me të drejta të garantuara për komunitetin serb, por edhe për komunitetet tjera sipas konventave ndërkombëtare, përkatësisht për shtet funksional, gjithnjë afër halleve të qytetarëve të saj.

Gjatë debatit u tha se dokument themelor për angazhimet e Grupit Negociator në procesin e statusit gjithnjë duhet të jetë Rezoluta për Rikonfirmimin e vullnetit të Popullit për Pavarësi dhe shtet Sovran e aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 17 nëntor të vitit 2005.

Mesazh i veçantë i kësaj seance ishte kërkesa për unitet në Parlament dhe në Grupin Negociator, në këtë vit vendimtar për të ardhmen e Kosovës.

Alush Gashi theksoi se Delegacioni i Unitetit vazhdoi rrugën ndërkombëtare të angazhimeve institucionale për pakicat, si kusht i fuqishëm ndërkombëtar



për pavarësi dhe sovranitet të vendit tonë. LDK-ja e Kosovës dhe brenda saj Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet përpjekjet vendore dhe ndërkombëtare për sigurim të plotë të të drejtave të njeriut në Kosovë, pa dallim të përkatësisë etnike. Duke mbështetur garantimin institucional të të drejtave të pakicave, sipas standardeve ndërkombëtare, rikonfirmojmë përcaktimin se organizimi eventual i pushtetit lokal në vija etnike nuk është qëndrim i LDK-së.

Lidhja Demokratike e Kosovës druan për pasojat e një pranimi apo të një imponimi të tillë. Duke shprehur falënderimin për bashkësinë ndërkombëtare, në veçanti për vendet e Grupit të Kontaktit dhe NATO-n, si dhe të fqinjëve tanë në mbështetje të procesit për pavarësi dhe sovranitet të plotë të vendit tonë, tha në vijim Gashi, jemi të interesuar të dëgjojmë nga Delegacioni i Unitetit ecurinë e bisedimeve dhe pikëpamjet për zbatim të ashtuquajturit paket statusor në muajt në vijim.

Vendime me konsensus të plotë të anëtarëve të Ekipit të Unitetit

Fatmir Sejdiu, presidenti i Kosovës



dhe njëkohësisht kryetar i Grupit Negociator të Kosovës, duke folur rreth zhvillimeve të procesit të bisedimeve për statusin e

Kosovës të udhëhequr nga Ahtisari, të cilit i është dhënë mandati i tillë me vendimin e KS të OKB-së, theksoi se Ekipi i Unitetit nëpërmjet delegacioneve përfaqësuese të tij ka prezantuar qëndrimet e veta në takimet e Vjenës për katër tema bosht, të cilat janë trajtuar në shtatë takime të deritashme në Vjenë, si dhe takime të tjera me vetë drejtuesin e këtyre bisedimeve, Presidentin Ahtisaari, të cilat janë

mbajtur në Prishtinë para pak ditësh. Po kështu Delegacioni i Kosovës në nivelin më të lartë të përfaqësimit politik ka marrë pjesë në një takim në Vjenë, ku ka shprehur qëndrimet e veta lidhur me të ardhmen e Kosovës, duke artikuluar fuqishëm vullnetin politik të popullit të Kosovës për pavarësinë dhe sovranitetin e plotë të Kosovës. Dua të theksoj se Ekipi i Unitetit me gjithë strukturën e tij të brendshme të organizimit, duke filluar nga Grupi Politik Strategjik dhe ekipet e specializuara për çështje kushtetuese-juridike, çështje ekonomike, çështje të trashëgimisë kulturore, çështje të të drejtave dhe lirive të komuniteteve, në përbërjen e të cilave janë të angazhuar ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, ka përgatitur dhe prezantuar në mënyrën më serioze qëndrimet e Kosovës nëpërmjet të dokumenteve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejt në bisedime. Prandaj, këto dokumente të përgatitura deri tani i keni para jush dhe reflektojnë qëndrimet tona, të marra si rezultat i analizës gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale që ka bërë Delegacioni i Kosovës dhe të gjitha ekipet e tjera, dhe se vendimet e prezantuara janë marrë me konsensus të plotë nga anëtarët e Ekipit të Unitetit.

Bisedimet më të gjata gjer tani (pesë takime) dhe takime të tjera në nivel ekspertësh janë zhvilluar lidhur me çështjet e decentralizimit të pushtetit në Kosovë dhe shumë aspekte të gërshetuara brenda këtij procesi. Çështje të veçanta të debatuarra më së shumti kanë qenë ato që kanë të bëjnë me formimin e komunave të reja në Kosovë, kompetencat dhe funksionet e tyre themelore, me një fokus të veçantë në çështjen e kompetencave të deleguara, që kanë të bëjnë me financat lokale, kujdesin shëndetësor dhe sekondar, arsimimin e lartë, policinë dhe drejtësinë, si dhe çështja e bashkëpunimit midis komunave. Delegacioni i Kosovës në bisedimet lidhur me decentralizimin është mbështetur gjithmonë në dokumentin e tij themelor “Parimet

themelore të Reformës së Pushtetit Lokal të 14 shkurtit 2006”, i cili si i tillë edhe do të jetë pjesë e marrëveshjes për statusin e ardhshëm të Kosovës. Bazuar në kriteret e para para të këtij dokumenti, në vazhdim të procesit është nxjerrë edhe dokumenti i radhës për krijimin e komunave të reja në Kosovë. Ne, këtë dokument, që është punuar si nga ekspertët vendorë, ashtu edhe ndërkombëtarë, janë paraqitur kriteret për krijimin e komunave të reja. Platforma e Kosovës për Reformën e pushtetit lokal, është e bazuar në një varg parimesh, të cilat reflektojnë frymën e dokumenteve kryesore relevante ndërkombëtare mbi qeverisjen lokale siç, janë: Parimet Evropiane të Subsidiaritetit, Karta Evropiane për Qeverisje Lokale, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe dokumente e konventa tjera relevante.

Komunat e Kosovës do të gëzojnë kompetenca të gjera duke filluar nga zhvillimi ekonomik dhe aspektet financiare, planifikimi urban, shërbimet publike, arsimit, shëndetësia dhe disa aspekte të përkujdesjes sociale. Po kështu do të ketë kompetenca të caktuara edhe në fushën e policisë, siç është zgjedhja e komandantëve të stacioneve në bazë të propozimit të Ministrisë të Rendit dhe kjo duhet të reflektojë strukturën etnike brenda komunës, reflektimi i kësaj strukture ka të bëjë edhe me përbërjen e qytetarëve.

Ky nivel i kompetencave duhet t'i nënshtrohet legjislacionit të Kosovës, duke mos cenuar asnjëherë kompetencat e parapara përmes këtij legjislacioni për pushtetin qendror, në relacion edhe me pushtetin lokal. Në dokumentin bazë janë ofruar edhe elemente të tjera që kanë të bëjnë me kompetencat e komunave të Kosovës. Çështje e veçantë në këtë drejtim është çështja e bashkëpunimit midis komunave të Kosovës, bashkëpunimi tejkuftar i tyre, pra edhe me komunat e Serbisë. Në këtë aspekt duhet theksuar se Delegacioni i Kosovës ka qëndrimin

e vet të palëkundur se ky bashkëpunim duhet të mbështetet në legjislacionin e Kosovës, Konventën e Madridit dhe Kartën Evropiane për Vetë-Qeverisje Lokale dhe me marrëveshje bilaterale midis Qeverisë së Kosovës dhe qeverive të vendeve të tjera, pra edhe të Serbisë. Duke pasur parasysh kriteret e miratuara për formimin e komunave të reja siç është numri prej 5,000 banorëve, qëndrueshmëria financiare dhe përbërja etnike e komunave, Delegacioni i Kosovës ka qëndrimin e vet përfundimtar për formimin e pesë komunave të reja dhe shtimin për disa parcela kadastrale të një komune ekzistuese, ku ka një shumicë të komunitetit serb.

Me këtë qasje kemi dëshiruar që të kontribuojmë në drejtim të integritetit sa më të madh të komunitetit pakicë serb në proceset vendimarrëse, pra edhe në nivelin lokal të vendimarrjes. Aspektet tjera të veçanta rreth zhvillimeve të bisedimeve në këtë temë u janë raportuar më herët në Kuvend. Delegacioni i Kosovës në Vjenë, në unitet të plotë dhe palëkundshëm, ka shprehur përcaktimin e vet për një Kosovë evropiane, në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke garantuar të ardhme të përbashkët në Kosovën e pavarur për të gjithë qytetarët, pra për shumicën dhe pakicën.

Standardet nuk janë sfidë e pakalueshme

Agim Çeku pohoi se implementimi



i standardeve nuk duket më sfidë e pakalueshme. Vlerësimi i sapo përpiluar teknik i standardeve dhe dinamika e treguar në

implementimin e plotë të trembëdhjetë kërkesave të Grupit të Kontaktit janë edhe një dëshmi e fuqishme dhe e pakontestueshme në

këtë drejtim. Ky vlerësim i pa publikuar ende është dokument bazë i seancës së ardhshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën që do të mbahet më 11 shtator të këtij viti. Përmbajtja e këtij vlerësimi është si argument më shumë i prodhimit të fakteve të reja, i prodhimit të realiteteve të reja, por mbi të gjitha është një dokument konfirmues i përcaktimit tonë për një Kosovë çfarë të gjithë e dëshirojmë. Dy kanë qenë çështjet kryesore që e kanë preokupuar opinionin publik dhe politik të Kosovës: decentralizimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore fetare në Kosovë. Për decentralizimin ne kemi ndjekur parime të njëjta, siç i thashë më lart dhe si i përmendi edhe presidenti, duke mbështetur Ekipin Negociator me të dhëna me ekspertizë, por edhe me angazhim të drejtpërdrejtë. Qëllimi ynë është që të bëjmë të mundur vetëqeverisjen lokale për pakicat me fokus të veçantë për atë serbe, por që në të njëjtën kohë të ruhen funksionaliteti i shtetit dhe qeverisja demokratike në tërë Kosovën. Ne besojmë që jemi në rrugë të mirë që t'i realizojmë synimet tona dhe t'u mundësojmë pakicave t'i realizojnë të drejtat e tyre të plota në shtetin e pavarur të Kosovës, që gjithsesi do të jetë edhe shtet i tyre. Kosova dhe shqiptarët në përgjithësi kanë qenë dhe janë model, besoj, në gjithë botën për tolerancën fetare. Trashëgimia kulturore dhe fetare nuk do të kishin qenë temë, kështu siç janë sot, sikur të mos kishte ndodhur marsi 2004. Nëpërmjet bisedimeve për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe fetare ne po dëshmojmë se populli ynë nuk ka asnjë dilemë rreth kësaj çështjeje. Marsi 2004 ka qenë një fatkeqësi, por kurrsesi vullnet i popullit të Kosovës.

Kosova ka fituar pavarësinë në qershor të vitit 1999

Hashim Thaçi theksoi se Ekipi i Unitetit ka bërë punë në kontinuitet, ka prezantuar qëndrimet e për-



bashkëta që ka menduar se janë më të mirat, por në veçanti ka bashkëpunuar mirë me bashkësisinë ndërkombëtare dhe ka marrë

vendime të urta. Gjatë procesit negociator në momente të veçanta dhe delikate janë vërejtur tendenca dhe prirje mediale të individualizimit të punëve, apo vrapit të keq në formën e grabitjes së suksesit të Ekipit të Unitetit ose të distancimit nga ndonjë lëshim që është bërë në punë. Të qenit sot në procesin negociator, si do që të jetë nesër, pozicioni i tij politik nuk duhet të vazhdojë të keqpërdoret nga askush për nevojat e konsumit politik apo betejave politike brenda partiake. Ky moment politik dhe historik është më tepër i rëndësishëm për popullin tonë se sa karriera politike e çdo individi.

Uniteti ruhet dhe kultivohet duke investuar angazhim, përkushtim, seriozitet dhe vendosmëri dhe kulturë, që ka vetëm një qëllim të lartë - interesin e vendit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Pavarësia dhe krijimi i shteti të Kosovës është obligim që rrjedh nga vullneti i qytetarëve, ndërsa është obligim i Grupit të Unitetit ta zyrtarizojë atë. Kosova ka fituar lirinë fizike dhe politike, pra pavarësinë në qershor të vitit 1999, sot ne duhet ta mbrojmë këtë të arritur dhe ta zyrtarizojmë. Partia Demokratike e Kosovës është duke marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të përkushtuar në këtë proces historik. Objektiv jetësor i secilit nga ne duhet të jetë ndërtimi i shtetit të Kosovës dhe jo ardhja apo ruajtja me çdo kusht e pushtetit.

Kosova e re duhet të jetë shtet i ndërtuar në themele të forta të vlerave demokratike të qytetërimit përëndimor.

Të ndërtojmë një cilësi të re marrëdhëniesh

“Në 10 muajt e fundit kemi punuar



me detyrë të veçantë për krijimin e një projekti të ri që ka të bëjë me marrëdhëniet ndërmjet popullit shumicë në Kosovë dhe komuniteteve

pakicë. Qëllimi ynë afatgjatë ka qenë që të ndërtojmë një cilësi të re marrëdhëniesh, një cilësi që nuk e kemi pasur deri më tani, një cilësi e cila do të reflektojë qëndrueshmërinë e shtetit të pavarur të Kosovës dhe të marrëdhënieve ndëretnike në të”, tha në fillim të fjalës së tij **Veton Surroi**. Në vijim ai tha se janë përdorur disa nocione ose disa parametra fillestarë. I pari është nocioni liberal i ndërtimit të shtetit të qytetarëve të Kosovës, por njëkohësisht duke pranuar se në atë shtet liberal të qytetarëve ekzistojnë interesa të komuniteteve etnike, interesa që duan të integrohen në rregullimin e ardhshëm kushtetues juridik të Kosovës. Pikënisja e dytë ka qenë fakti që ekziston një realitet demografik dhe atë duhet respektuar, ai realitet demografik flet për një përqindje prej 90 për qind të popullit shumicë dhe 10 të komuniteteve pakicë, realitet politik që rrjedh nga procesi negociator, nga tërë historia paraprake. Në këtë frymë në definimin e statusit një vëmendje e veçantë i dedikohet komunitetit serb në rregullimin e këtyre marrëdhënieve. Pikënisje ka qenë evoluimi i përherëshëm i nocioneve të së drejtës apo të mbrojtjes së komuniteteve në Evropën e sotme.

Në duar e keni dokumentin që është platformë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë, në metodologji jemi nisur nga përgjigjet e pyetjeve që na i ka paraqitur z. Ahtisari për atë se si mendojmë se do të dukej Kosova e ardhshme në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave të

komuniteteve. Jemi nisur nga një parim i thjeshtë konsultativ, kemi filluar të konsultohemi me njëri-tjetrin dhe kemi kaluar në disa raunde konsultimesh, qoftë në Kosovë, qoftë në Durrës, qoftë në Selanik, me ndihmën e madhe të Qendrës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Minoriteteve dhe z. Veler personalisht. Në dokumentin që e keni në duar do të shihni se baza e mbrojtjes, shtylla kurrizore e mbrojtjes së ardhshme të drejtave të komuniteteve pakicë, është ligji i veçantë kushtetues, që duhet ta kalojë Kuvendi, një ligj i veçantë kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, me këtë ligj të veçantë të drejtat e komuniteteve bëhen pothuajse të pandryshueshme. Kjo është garanci e fortë për të gjitha ato komunitete pa marrë parasysh se çfarë është numri i tyre.

Është insistimi ynë që në pjesëmarrje në Kuvend të jenë të drejtat e garantuara e jo të rezervuara, të mos ekzistojë gjykatë e apelit e veçantë për komunitetet ose etnifikim i gjykatës dhe është insistimi ynë që pjesëmarrja në Qeveri të mos ketë demonacion etnik, theksoi Surroi.

Xhezair Murati tha se anëtarët e



Këshillit konsultativ deri më tash kanë marrë pjesë në tri konferenca; në Durrës, Selanik dhe Shkup dhe ky folës ka qenë pjesëmarrës i të gjitha

atyre konferencave dhe dokumenti të cilin e kemi konceptuar i është dorëzuar Ahtisarit, derisa përfaqësuesit e pakicave dhe pjesëmarrësit e atyre konferencave nuk e kanë ratifikuar atë, as e kanë parë me sy. Në konferencat e përmendura jemi dakorduar për të drejtat e rezervuara e jo për ato të garantuara, sepse të drejtat e garantuara ne na limitojnë. Ne nuk dëshirojmë asgjë më pak se që përmban Korniza kushtetuese dhe për atë ashtu jemi dakorduar në Selanik. Unë pas një diskutimi të

gjatë në konferencë në Selanik e di, sikurse edhe të gjithë të tjerët, kemi vendosur që megjithatë të ruhen të drejtat e rezervuara e jo të garantuara.

Gjergj Dedaj propozoi që Kuvendi të shpallë urgjentisht pavarësinë e Kosovës, të fillojë procedurën për hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe njëkohësisht të luten qendrat ndërkombëtare në botë, në SHBA dhe në Evropë, si dhe Këshilli i Sigurimit që ta njohin pavarësinë e Kosovës, para se të bëhet shumë vonë.



Gjylnaze Sylja pohoi se pavarësia do të arrihet, por duhet të jemi të kujdesshëm. Koha deri në përfundimin e procesit dhe në përcaktimin e statusit të Kosovës do të jetë një presion i madh për të gjithë ne dhe me siguri posaçërisht në Delegacionin e Kosovës që të pajtohet me propozimet ndërkombëtare. Progresi i arritur deri më tani mund të rrezikohet nëse bisedimet për decentralizim udhëhiqen nga parimi etnik i cili mundëson krijimin e komunave në baza etnike, për më tepër kjo mund të rrezikojë stabilitetin e tërë rajonit. Qasjen e Ekipit të Unitetit që brenda tërësisë së Kosovës të arrihet realizimi maksimal i të drejtave për minoritetet, Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet plotësisht, por duhet të merret parasysh funksionaliteti i shtetit të Kosovës, si tërësi dhe shtet demokratik. Jemi ne qytetarët e Kosovës që duhet të jetojmë me pasojat e zgjidhjes dhe jemi ne që do të paguajmë çmimin nëse zgjidhja nuk është e realizueshme ose nëse shkakton rritjen e problemeve të sigurisë, të atyre sociale,

politike dhe ekonomike në të ardhmen.

Emrush Xhemajli duke iu referuar



Kosovës, Për më tepër kjo ka ndodhur në kohën kur ajo vazhdon me shumë sukses luftën kundër Kosovës. Ju e keni rehabilituar dhe legjitimuar dhe amnistuar Serbinë për krimet që ka bërë dhe keni lënë gojëhapur kundërshtarin, pse të kërkojë falje Serbia kur kjo nuk i kërkohet pikërisht nga ata që pa kurrfarë kushti janë ulur në tavolinë në anën tjetër. Pse Serbia s'e njeh realitetin e krijuar në Kosovë dhe vullnetin e qytetarëve të Kosovës, kur këtë nuk e ka kusht për marrëdhënie me Kosovën. Secili takim me palën serbe është duke e zbehur çështjen e pavarësisë, sepse këto takime po reflektojnë mesazhe tragjike për Kosovën”.

Jakup Krasniqi tha se Grupi



Parlamentar i PDK-së e mbështet këtë formë të komunikimit të Grupit Negociator me Kuvendin dhe me opinionin publik të Kosovës. PDK-ja dhe Grupi Parlamentar i saj edhe pse në fillim i kemi pasur vërejtjet tona serioze, ne nuk kemi qenë e as nuk jemi opozitë e këtij procesi tepër të rëndësishëm për të sotmen dhe për të ardhmen e Kosovës, madje mund të themi se tani ky proces është shumë më i ndritshëm se në fillimin e tij. Roli i opozitës në këtë proces ka qenë i rëndësishëm për të mos thënë mjaft përcaktues. Ne edhe pse shpesh nuk ishim të kënaqur me nivelin e për-

faqësimit të interesave të qytetarëve të Kosovës, kemi qenë të angazhuar sinqerisht dhe seriozisht në këtë proces. Angazhimi ynë ka qenë dhe vazhdon të jetë vetëm në shërbim të shtetit të pavarur dhe sovran, asnjë arsye tjetër, as nuk na ka obliguar dhe as nuk na obligon të jemi pjesë e tij, për faktin se ky është vullneti i popullit shumicë të Kosovës, i shqiptarëve, ky është vullneti i luftëtarëve të lirisë, i dëshmorëve të kombit, ky është vullneti i komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jasharit dhe i tre brezave të Jasharajve që u flijuan për liri, që është rast unik në historinë e përbotshme, ku njëkohësisht bien tre breza për lirinë e vendit të vet, pa të cilët nuk do të ndodhnin proceset demokratike të kësaj dekade, nuk do të ndodhnin as këto negociata e as kjo pritje e madhe me të drejtë për shtetin ligjor. Grupi Negociator i Kosovës, përveç ofertës së ofruar duhet t'i ketë edhe këto kërkesa garantuese:

Tërësinë territoriale të Kosovës me sovranitet,

Kosova me njohje ndërkombëtare dhe ulëse në OKB,

Kosova me ushtrinë e saj profesionale,

Mitrovica qytet me dy njësi komunale,

Financimi i komunave për kokë të banorëve të saj,

Reciprocitetin.

Çdo gjë që do ta gëzojnë serbët e Kosovës, ta kenë edhe shqiptarët në Kosovën Lindore, në Serbi dhe kudo ku ata jetojnë dhe janë pakicë.

Mahir Jagicillari tha se është e



pa kon - testueshme se Kosova sot po kalon përmes një periudhe mjaft të rëndësishme, në të cilën do të përcaktohet statusi dhe ardhmëria e Kosovës. Ndërkaq, ardhmëria e Kosovës nënkupton edhe stabilitetin në regjion, prosperitetin ekonomik

dhe bashkëpunimin me bashkësinë ndërkombëtare, në bashkëjetesë me shumicën shqiptare dhe komunitete të tjera.

Në parim ne mbështesim decentralizimin si mundësi për shërbim më të mirë të qytetarëve. Sa i përket dokumentit për komunitetet dhe përkundër pjesëmarrjes sonë në pjesën më të madhe të hartimit, me keqardhje konstatojmë se nuk jemi kyçur në fazën përfundimtare të hartimit.

Jemi të mendimit se edhe për një periudhë të caktuar kohore do të mbeten vendet e rezervuara. Sa u përket të drejtave gjuhësore, këtu kanë ndodhur ndryshime drastike.

Në periudhën ndërmjet dokumentit të fundit dhe këtij dokumenti të sotëm në pjesën për gjuhët ndryshimi ekziston një faqe të tërë tekstit. Dokumenti i sotshëm, d.m.th. pika 8.1 dhe 8.2 vetëm adresohet në Ligjin për gjuhën i cili është kontestuar nga Bashkësia turke. Pastaj në pikën 5.6.1 thuhet se ndryshimet e ligjit do të bëhen me procedurë votimi 2/3 dhe me votim të dyfishtë.

Prandaj, edhe një herë dëshiroj të përsëris se versioni i dokumentit të sotëm për të drejtat e komuniteteve nuk është dokumenti i miratuar në seancën e kuorumit këshillëdhënës. Që të mos vij në të ardhmen deri tek interpretimi i gabueshëm, dëshiroj që sot këtu së bashku ta shqyrtojmë. Në qoftë se këtë e lëmë për bisedimet e ardhshme të cilat do të mbahen në Vjenë, mendoj se atëherë do të jetë i parëndësishëm dhe se do të humbim të gjithë.

Provë që të enklavizohen minoritetet, të krijohet jetë paralele



Sabri Hamiti tha se ka respekt të madh për mundin që është bërë në diskutimin për pakicat në shtetin e Kosovës, ndo-

nëse ne kemi thënë se për këto probleme do të duhej të bisedohej vetëm në shtetin e pavarur të Kosovës, sepse çdo gjë përpara është paragjykim, por ne kemi hyrë në traset e këtij gjykimi ose paragjykimi dhe kemi bisedime në nivelin e decentralizimit, që përkthyer në punën e deritashme të Ekipit të Kosovës është krijimi i komunave me shumicë serbe. Kjo është e vërteta, emri decentralizim një herë ka dalë si emër i dytë për transformimin e pushtetit lokal, por nuk është. Ne tash kemi prapë decentralizim që unë për vete nganjëherë, pasi qendër nuk ka dhe them po ndahet bashkësia, sepse pushtet qendror pos improvizimeve ne nuk kemi pasur në Kosovë nën UNMIK-un. Në vijim Hamiti theksoi se ato që kanë ndodhur me punën e decentralizimit janë në të vërtetë provë që të enklavizohen minoritetet, konkretisht serbët që të krijojnë një jetë paralele politike, që të financohen në mënyrë të ndryshme dhe më në fund që të dirigjohen dhe të bëhen instrument i Beogradit, në mënyrë të institucionalizuar ata edhe tash janë instrument, por atëherë bëhen lojalë.



Nazim Jashari theksoi se politika e Beogradit është politikë e rryer 130 vjet, kanë shtetësi në kontinuitet dhe t'i vijë radha që z. Haziri apo Kosumi t'ua hedh atyre me mashtrim e është absurde dhe tepër tendencioze, prandaj futja qorrazi në këtë proces të decentralizimit na ka shkaktuar dëm, sepse ne kemi hyrë në këtë proces me dy komuna (flasim për Parteshin dhe Graçanicën) janë dhënë që në fazën e parë të decentralizimit edhe Graçanica edhe Parteshi dhe janë dhënë thjesht, thuaja se asgjë nuk po ndodh, për kundër të gjitha vërejtjeve nga deputetët.

Po futemi në ujërat e segregacionit

Nekibe Kelmendi tha se po kërkohet të themelohen edhe gjykata të qarqeve si gjykata instanciale të gjykatave themelore apo të gjykatave komunale për komunitete



pakicë, që do të thotë se ne po futemi në ujërat e segregacionit, po ndahemi. Kjo nuk duhet të ndodhë, sepse jemi shtet në transicion të dyfishtë, në transicion prej komunizmit, në transicion prej luftës, tash po shkojmë në një drejtim krejt tjetër, prandaj ju kisha lutur që për gjykatat të pyetet Këshilli Gjyqësor Prokurorial, që ky t'i japë rekomandimet dhe ky kuvend ta bëjë emërimin apo zgjedhjen e gjyqtarëve dhe të prokurorëve e jo, siç thuhet në dokument, që në një farë mënyre nuk është drejtpërdrejt e thënë, por për derë të vogël është futur dhe propozohet të kërkohet mendimi i komunitetit pakicë prej nga vjen gjyqtari i komunitetit pakicë, ai gjyqtar do të jetë i varur prej komunës prej së cilës është propozuar dhe në këtë mënyrë edhe parimi i pavarësisë së gjyqësorit do të rrënohet.

Ferid Agani parashtrroi propozimin e Partisë së Drejtësisë të mbështetur nga Grupi Parlamentar për Integrim që Kuvendi i Kosovës në këtë seancë të nxjerrë



deklaratë me të cilin i informon Grupin e Kontaktit dhe anëtarë të tjerë të Këshillit të Sigurimit, se propozimet e ofruara nga Grupi i Unitetit gjatë bisedimeve teknike në Vjenë do të mbështeten nga Kuvendi i Kosovës vetëm në rastin kur

Kosovës do t'i garantohet sovraniteti i plotë, me sigurimin e përfaqësimit të saj si shtet i pavarur në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, me të drejta të barabarta si të gjitha shtetet e tjera anëtare të OKB-së.

Bajram Kosumi theksoi se ndarja territoriale ose etnike e komunave, siç u tha nga disa parafolës, nuk krijon siguri, në radhë të parë për komunitetin serb që jeton në ato komuna dhe



këtë çështje duhet ta diskutojmë bashkë me UNOSEK-un dhe ta argumentojnë ekspertët tanë dhe delegacioni ynë fuqimisht, por po ashtu krijimi i komunave të reja nuk lehtëson jetën e qytetarëve në ato komuna, nuk ofron vendimmarrje më afër qytetarit, por shpeshherë ndodh e kundërta. Këtë e ilustron ky shembull: banorët e fshatit Koretishtë të Gjilanit sot e kanë ndërtesën e komunës vetëm 3 kilometra larg, për çdo dokument ata duhet të udhëtojnë tre kilometra deri te komuna etj., ndërkaq nëse ndodh të bëhet realitet propozimi për komunën e Artanës do të thotë Novoberdës, banori i Koretishtës do të shkojë te ndërtesa e komunës 15 kilometra dhe në këtë rast është e kuptueshme pse politikanët serbë po e kërkojnë diçka të tillë, ata kanë interesa politike.

Mark Krasniqi tha se në kemi qenë gjithmonë dhe jemi që të zgjidhet problemi në mënyrë paqësore me negociata, me marrëveshje, por duket se faktori ndërkombëtar këto negociata, këto marrëveshje i ka kuptuar shumë keq. Me lëshimin pe të palës kosovare ,d.m.th. në favor të Serbisë. Duket se këtu po përkëdhelet me tepër Serbia sesa po lufto-

het për të drejtat e pakicave kombëtare në Kosovë.

Adrian Gjini shprehu mendimin se



kompromiset që janë arritur nuk e cenojnë funksionalitetin e shtetit të Kosovës, është diçka që po përsëritet, pra duhet t'ju them se ekziston bindja se edhe UNOSEK-u edhe kryendërmjetësuesi Ahtisari edhe Grupi i Kontaktit e kanë të njëjtin synim që Kosova të jetë shtet funksional, nuk synojnë të ndërtojnë shtet të dështuar.

Kemi punuar me konsensus. Nëse dikush me pyet mua se çka mendoj se afër 15 % të territorit do të menaxhohet në kuptimin e menaxhimit komunal prej komunitetit pakicë që përbën 5% , se a është shumë apo është pak, për hir të korrektësisë politike do t'ju them se është në fakt më se mjaftueshëm.

Është ruajtur struktura unike, uniforma dhe zinxhiri komandues i Shërbimit Policor të Kosovës

Lutfi Haziri theksoi se katër detyra janë kryesore që përfshihen në rrafshin e pushtetit lokal dhe që garantohen me Ligj nga institucionet qendrore: zhvillimi lokal ekono-



mik, arsimit, shëndetësia dhe menaxhimi i pronave, si dhe 20 detyra të tjera të përditshme që ushtrohen nga pushteti lokal dhe kjo nuk është risi. Ky është konfirmim në parim i kompetencave të komunave edhe në gjendjen e pas statusit në Kosovë të pavarur. Nga katër detyra apo përgjegjësi të deleguara në komunë, ne kemi pranuar që të jenë edhe dy detyra shtesë. Parimi i delegimit të

detyrave në nivel lokal nënkupton vetëm ushtrimin e detyrave sipas ligjit nga autoritetet lokale, ndërsa përgjegjësinë ligjore e mban pushteti qendror. Praktikisht regjistrimi civil dhe dokumentet civile sot janë detyrë që ushtrohen nga komuna, ndërsa është në kompetencë të Ministrisë të Punëve të Brendshme. E kam fjalën për letërnjoftime dhe pasaporta. Kjo detyrë deri para themelimit të kësaj ministrie ka qenë e menaxhuar nga Ministria e Shërbimeve Publike. Ruajtja e pyjeve dhe asistencë sociale sipas ligjit të miratuar në këtë parlament, do të jenë detyra të deleguara në rrafshin e pushtetit lokal.

Asistencë sociale nënkupton që komunat të kenë të drejtë të rishikojnë kartelën sociale në komuna dhe t' i shpërndajnë fizikisht, duke e përfshirë edhe stafin, stafin që aktualisht e ka Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Në segmentin e arsimit, Kosova garanton që arsimit fillor dhe i mesëm menaxhohet nga autoritetet lokale në kuptimin e pronës, të mësimdhënësve dhe përgjegjësive të tjera, që janë të përcaktuara sipas ligjit në Kosovë. Garanton që alfabeti dhe gjuha serbe do të jenë e drejtë e garantuar me Kushtetutë, që ushtrohet në pushtetin lokal si gjuhë zyrtare në Kosovë dhe po ashtu u jepet rol komunave në emërimin e drejtorëve në shkollat e mesme dhe fillore, sipas përgjegjësisë së ndarë si është sot me ligj e përcaktuar, ku ministri i Arsimit i emëron sipas rekomandimit të një paneli profesional.

Te policia janë ruajtur struktura unike, uniforma dhe zinxhiri komandues i Shërbimit Policor të Kosovës. Është ruajtur struktura e uniformave dhe zinxhiri komandues, por i njihet e drejta e asamblesë komunale, jo kryetarit të komunës, jo individit, asamblesë komunale, ku kryetari i komunës udhëheq, i cili në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të marrë pjesë në emërimin e komandantit lokal të stacionit të policisë sipas kriterëve

që ekzistojnë sot. Njëri nga kriteret që të emërohet një komandant policie në nivel të komunave, duhet të jetë kapiten me gradë, duhet t'i plotësojë kriteret morale dhe të tjera dhe kjo e drejtë ndahet në këtë formë, ku një listë e propozuar nga Ministri i Punëve të Brendshme prej tre emrave zgjidhet apo propozohet nga asambleja komunale, në mënyrë që formalizmi dhe emërimi formal i këtij emërimi, ndodh nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Në Kosovë sipas këtij parimi nuk mund të ketë rajone, distrikte dhe shtresë të tretë të pushtetit të ndërmjet Qeverisë dhe komunave dhe po ashtu është eliminuar substrukura komunale. Nuk kemi lejuar që në pjesën e resurseve më të mëdha që Kosova posedon sot, si p.sh, Obiliqi, Vushtrria dhe Mitrovica, të lejohet themelimi i komunave sipas propozimit që ka qenë nga ana e delegacionit tjetër dhe qëndrojmë edhe më tutje prapa këtij propozimi. Pra nuk ka mundësi reale që Kosova ta rritë numrin më shumë se 5 të themelimit të komunave me shumicë etnike serbe, plus nënkupton zgjerimin i komunës aktuale të Novo Bërdës, sepse gjeografikisht janë të lidhura në drejtim të komunës së Gjilanit dhe të Kamenicës me një popullatë.

Naim Maloku shprehu shqetësim për faktin se Grupi i Unitetit dhe Grupi Politik Strategjik dhe grupet e tjera teknike që janë ngritur në lidhje me procesin për të cilin është




fjala sot, pak janë marrë me çështjen e sigurisë në Kosovë, me mekanizmat e sigurisë të cilët do t'i ketë Kosova si shtet. Ai tha se nuk është i njoftuar se është ngritur grupi teknik për çështjet e sigurisë dhe deri ku kanë arritur përgatitjet dhe si është formuluar kërkesa dhe oferta e palës kosovare për këtë çështje. Lidhjet që po i kërkon Serbia me

komunat, si po thonë ata serbe në Kosovë, do të jenë burim i destabilitetit dhe bazë që Serbia në të ardhmen të ndërhyjë në punët e brendshme të Kosovës dhe të jetë një burim ngritjes së pasigurisë në Kosovë dhe destabilitetit të brendshëm, theksoi Maloku.

Ramadan Musliu theksoi rastin e reagimit të qytetarëve të Vitisë kundër formimit të Komunës së Klllokotit, e cila Komunën e Vitisë e ndan në tri pjesë, me çka nuk pajtohen qytetarët e kësaj ane.



Flora Brovina tha se bisedimet për të zhdukurit gjatë luftës mbeten peng në nivelin më të ulët të bisedimeve, pra në nivelin teknik. Kjo çështje nuk u ngrit në nivelin e bisedimeve në Vjenë edhe pse duhet të arrinte para se të fillonin bisedimet e njëanshme ose një nacionale për monumentet kulturore.



Ymer Muhaxheri dha këto propozime :



1. Rruga që kalon nëpër Grykën e Rugovës, gjegjësisht përmes Qakorit e lidhet me Malin e Zi, e cila kalon përbri Patrikanës së Pejës të mos futet brenda kufijve të zonës mbrojtëse;

2. Kanali i ujitjes të mbetet jashtë zonës së mbrojtjes së Patrikanës së Pejës;

3. Resurset e ujësjellësit gjithashtu të kursehen nga futja në zonën mbrojtëse;

4. Të punohet dokumenti rregullativ për administrimin e zonave të

mbrojtura, me theks të veçantë objektet e zonat e mbrojtura duhet të shpallen si objekte të rëndësishme të veçantë;

5. Zona e mbrojtur e Patrikanës së Pejës përfshin Zonën e mbrojtur e të Patrikanës së Pejës që është nën kontrollin e KFORI-it e që në kujtesën popullit, është perceptuar si zonë e kufizuese me mure të larta - Patrikana.

6. Në Livadhet të Popit, pozicioni 6 dhe livadhet në anën e djathtë të rrjedhës së lumit pozicioni i shtatë përballë hyrjes së Kishës të mbetet jashtë zonës mbrojtëse e jo ashtu siç ka vepruar Ekipi Negociator për këtë çështje.

Fatmir Sejdiu në përfundim të punimeve të kësaj seance tha se është plotësisht dakord me të gjithë ato që u thanë. Secila nga pjesët e debatuar nuk është krejt çështje teknike, është çështje që ka edhe elemente politike, sepse është pjesë e sistemit dhe e një përpjekjeje për të ndërtuar formulat apo strukturat e ardhshme të shtetit të Kosovës. Natyrisht, mu në këtë përpjekje dëshirojmë që Kosova e ardhshme të funksionojë në radhë të parë si një shtet modern dhe demokratik, që akcepton standardet ndërkombëtare. E them me përgjegjësi dhe besoj edhe ju pajtoheni se Kosova ka nevojën e aderimit në të gjitha konventat ndërkombëtare.

Kosova ka nevojë edhe për një periudhë për një prezencë të lehtë ndërkombëtare. Në Kosovë ka nevojë për forcat e NATO-s deri në ngritjen e një force mbrojtëse të Kosovës në pajtim me standardet e NATO-s dhe ato ndërkombëtare.

Shefi i Grupit Negociator dhe anëtarët e këtij grupi në fund të debatit çmuan lart angazhimin e deputetëve në këtë seancë, duke vlerësuar se këto angazhime do të jenë ndihmesë e madhe për aktivitetin e mëtejshëm të këtij delegacioni.

Vizitë që forcon bashkëpunimin dhe miqësinë

*Kolë Berisha: Kosova pret dhe shpreson që Sllovenia ta njohë pavarësinë e Kosovës
France Cukjati: Sllovenia respekton të drejtën e popujve për vetëvendosje*



Delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga kryeparlamentari Kolë Berisha, në kuadër të vizitës dyditëshe në Slloveni, ka nisur sot takimet dhe bisedat në Parlamentin e Sllovenisë. Në delegacionin e Kuvendit të Kosovës janë edhe të gjithë anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Naim Maloku, Gazmend Muhaxheri dhe Mahir Jakgjillar, si dhe dy këshilltarët e kryeparlamentarit Berisha: Ramë Manaj dhe Skënder Durmishi. Takimi i parë u zhvillua me kryetarin e Kuvendit Nacional të Sllovenisë, z. France Cukjati. Të dy homologët e konfirmuan vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për intensifikim të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy parlamenteve. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, falënderoi Slloveninë dhe Kuvendin e këtij vendi për asistencën e vazhdueshme në Kosovë e veçanërisht në ndërtimin e strukturës moderne të Parlamentit të Kosovës. Kryeparlamentari Berisha paraqiti një pasqyrë të zhvillimeve aktuale në Kosovë dhe njoftoi për ecurinë e punëve dhe të reformës në parlament.

Temë e rëndësishme e këtij takimi ishte vlerësimi i përbashkët për domosdonë e gjetjes së zgjidhjes për statusin e Kosovës, sa më shpejt që të jetë e mundur.

Një urë lidhëse ndërmjet Kosovës dhe Unionit Evropian

Kryeparlamentari slloven, z. Cukjati, tha se koha po punon për Kosovën dhe u shpreh me optimizëm se Kosova do t'i realizojë qëllimet e veta. Në këtë takim, si dhe në paraqitjen e përbashkët para mediave, zoti Cukjati theksoi se Sllovenia, që nga koha e Austro-Hungarisë, përkrah parimin e të drejtës së popujve për vetëvendosje, prandaj e përkrah këtë parim edhe në rastin e Kosovës. Jam i bindur, tha ai, se perspektiva e Kosovës është në Unionin Evropian. Sllovenia është një urë lidhëse ndërmjet Kosovës dhe Unionit Evropian dhe në këtë funksion, ky komunikim ndërmjet dy parlamenteve ka një rol dhe rëndësi të veçantë. Cukjati, në këtë takim, doli me propozimin që të krijohet një asociacion i partneritetit të parlamenteve të rajonit. Kemi një pjesë të përbashkët të historisë, tha

Cukjati, dhe kjo tani është si lehtësim për bashkëpunim në të gjitha fushat edhe në atë të ekonomisë dhe pranisë aktive me investime.

Para mediave, kryeparlamentari i Kosovës, Berisha, dhe homologu i tij slloven, Cukjati, deklaruan interesimin për bashkëpunimin dhe forcimin e miqësisë ndërmjet Sllovenisë dhe Kosovës.

Në pyetjen e drejtpërdrejtë se çka pret Kosova nga Sllovenia lidhur me statusin, zoti Berisha tha se Kosova pret nga Sllovenia, sikurse edhe nga vendet e tjera, që ajo ta njohë pavarësinë e Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha shpjegoi edhe para mediave rëndësinë dhe përparësitë që ka njohja e pavarësisë së Kosovës, jo vetëm për Kosovën, por edhe për paqen e stabilitetin në rajon.

Një takim tjetër i rëndësishëm, gjatë ditës së parë të vizitës është zhvilluar edhe me kryetarin e Këshillit për Politikë të Jashtme të Kuvendit të Sllovenisë, z. Jozhef Jerovshek.

Edhe në këtë takim, kryeparlamentari Berisha ka paraqitur koordinatat e bashkëpunimit ndërkombëtar të Kosovës, përpjekjet integruese të Kosovës drejt BE-së, si dhe rolin që

ka Sllovenia si vend anëtar i BE-së për të ndihmuar këto integritete të Evropës Juglindore dhe të Kosovës. Shumë hollësi e propozime konkrete, në këtë temë, janë paraqitur në vazhdim nga z. Sabri Hamiti, i cili ka folur në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Kuvendit të Kosovës. Ai theksoi se Sllovenia ka një rol të rëndësishëm për faktin se është në BE dhe i njeh mirë rrethanat në Kosovë. Hamiti ka theksuar se pavarësia e Kosovës është kompromisi më i madh i shqiptarëve dhe ka tërhequr vërejtjen se nëse do të ketë shtyrje eventuale të zgjidhjes së statusit, mund të shfaqen tensione dhe nuk mund të ketë zgjidhje të problemeve ekonomike e sociale të Kosovës, të cilat janë grumbulluar në pritje të çështjes së statusit.

Edhe anëtari tjetër i Kryesisë, Xhavit Haliti, ka folur për rreziqet që bart shtyrja eventuale e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Ndërkaq, Mahir Jakgjillar ka paraqitur para zyrtarëve të Kuvendit të Sllovenisë standarde të larta dhe të drejtat e pakicës turke, si dhe të pakicave të tjera në Kosovë. Jakgjillar ka theksuar se zgjidhja e statusit të Kosovës duhet të bëhet duke respektuar vullnetin e shumicës së popullit të Kosovës.

Në këtë temë kanë kontribuar edhe dy zyrtarë të tjerë të lartë të Kuvendit të Sllovenisë, Lavitzhar Bebler, përfaqësuese e Sllovenisë në Këshillin e Evropës, dhe Jozhef Shkolc, të cilët kanë shprehur mirëkuptimin që statusi të definohet sa më shpejt dhe kanë nënvizuar se qëndrimi i Sllovenisë është në frymën e qëndrimeve të Bashkimit Evropian dhe të asociacioneve të tjera ndërkombëtare ku aderon Sllovenia.

Një takim shumë i rëndësishëm dhe i dobishëm është zhvilluar me zëvendëssekretarin e përgjithshëm të Kuvendit slloven, z. Matjazh Plevelj, dhe me bashkëpunëtorët e tij. Ky takim u përqendrua më shumë dhe më konkretisht në përvotat dhe në specifikat e punëve në

Parlamentin e Sllovenisë, sidomos mënyrat që shtojnë efikasitetin. Në këtë takim u diskutua për çështje procedurash, mënyrën e miratimit të buxhetit, raportet me qeverinë, përcaktimin e rendit të ditës në kuvend, interpelancat, debatet etj. Në këtë takim dhe në këtë temë morën pjesë

Në të mbërritur në Aeroportin e Prishtinës, Berisha u ka deklaruar gazetarëve se në takimet që ai bashkë me anëtarët e Kryesisë ka pasur me kryetarin e Kuvendit Nacional të Sllovenisë, France Cukjati, me kryetarin e Këshillit për Politikë të Jashtme, Jozhef Jerovshek, me zëvendësministrin Bozho Cerar e me funksionarë të tjerë slloven, ka pasur bisedime për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet të dy vendeve, në të cilat është konfirmuar bashkëpunimi dhe miqësia e ndërsjellë.

Me të gjithë bashkëbiseduesit gjetëm edhe një përkrahje të mirë për çështjen e statusit, ka theksuar Berisha.

Në pyetjen e një gazetari lidhur me deklaratën e tij në Slloveni se në rast të mos arritjes së pavarësisë deri në fund të vitit, mund të ketë revolta në Kosovë, deklaratë e cila ka ngjallur komente tek kërret serbë, Berisha është përgjigjur se deklaratat e tij është reale. Nëse populli i Kosovës nuk realizon aspiratat e veta, revoltat janë të pritshme dhe të arsyeshme ka thënë kreu i legjislativit, i cili është shprehur optimist se pavarësia do të ndodhë.

me kontribute të rëndësishme të gjithë anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Në fakt, u konstatua se kjo sferë duhet të jetë çështje e bashkëpunimit të vazhdueshëm përmes komisioneve, vizitave punuese, instruksioneve, etj.

Sllovenia ndjek me vëmendje zhvillimet në Kosovë

Takimi i fundit i ditës së sotme është zhvilluar në Ministrinë e Punëve të

Jashtme, me zëvendësministrin z. Bozho Cerar, i cili njëherësh është edhe sekretar shtetëror.

Zoti Cerar theksoi se Sllovenia ndjek me vëmendje zhvillimet në Kosovë, si dhe ecurinë e negociatave dhe përkrah fuqishëm punën e z. Ahtisari dhe të Grupit të Kontaktit. Përsërisht, tha ai, avancimet e bëra në përmbushjen e standardeve. Lidhur me statusin, zoti Cerar theksoi se ne dëshirojmë të gjendet zgjidhje e pranueshme për të gjithë dhe, në këtë zgjidhje, të përfshihet edhe perspektiva evropiane e Kosovës. Kosova, vazhdoi ai, besoj se do të ecë gjurmëve të Sllovenisë për t'u inkuadruar në familjen e madhe evropiane. Perspektiva evropiane është formula që zgjidh të gjitha problemet në rajon.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Berisha foli për punën në Kuvendin e Kosovës dhe përgjithësisht për konsolidimin institucional në Kosovë. Ai paraqiti vizionin e Kosovës së nesërme si një shtet i qytetarëve të barabartë me të drejta të garantuara për komunitetet pakicë dhe me orientimin bazë për perspektivë të ndritshme, duke shfaqur shpresën se Sllovenia do të mbështesë edhe më tej çështjen e Kosovës. Në kërkesën e shtruar nga z. Sabri Hamiti për liberalizim e vizave hyrëse në Slloveni, z. Cerar theksoi se u përmbahen rregullave të BE-së, por premtoi se do të bëhen përpjekje për të lehtësuar hyrjet për kategori të caktuara siç janë studentët, qeveritarët dhe afaristët.

Për delegacionin e Kuvendit të Kosovës sot u shtrua një drekë pune nga kryetari i Kuvendit të Sllovenisë, z. Cukjati.

Në të gjitha takimet u shtrua kërkesa e palës kosovare për zgjidhje të statusit të Kosovës sa më shpejt që të jetë e mundur dhe për këtë kërkesë pati mirëkuptim nga nikoqirët. Po kështu, në të gjitha takimet e sotme u vlerësua rëndësia e bashkëpunimit aktiv ndërmjet dy parlamenteve.

Kjo vizitë ishte në funksion të forcimit të bashkëpunimit dhe miqësisë ndërmjet Kosovës dhe Sllovenisë.

Do të vazhdojë procesi për përcaktimin e statusit të Kosovës sipas agjendës së Grupit të Kontaktit

*SHBA-të kanë ndjeshmëri për Kosovën, por edhe përgjegjësi për ta ndihmuar në rrugën e saj drejt ardhmërisë
Institucioneve të Kosovës iu bie barra kryesore për zhvillimin e vendit*

Janë bërë hapa të mirë për plotësimin e standardeve

*Komunat duhet të jenë të afta të mbijetojnë ekonomikisht dhe t'i kontribuojnë zhvillimit të vetë dhe të Kosovës
Anëtarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare ishin unik për Kosovën e pavarur dhe për kontributin e jashtëzakonshëm të SHBA-ve në rrugën e Kosovës drejtë lirisë dhe përparimit*



Anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe shefat e grupeve parlamentare kanë pasur sot një takim me të dërguarin e posaçëm të SHBA-ve për Kosovë, ambasadorin Frenk Uizner, me të cilin kanë biseduar për procesin negociator për përcaktimin e statusit të vendit, duke prezantuar vullnetin politik të popullit të Kosovës për pavarësinë dhe shfaqur këmbënguljen e tyre që statusi të zgjidhet brenda këtij viti.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, duke e falënderuar ambasadorin Uizner për vizitën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të SHBA-ve për lirinë e Kosovës, ka përvijuar punën që ka bërë Kuvendi i Kosovës për plotësimin e standardeve, duke theksuar në mënyrë të veçantë miratimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, atë për Lirinë fetare dhe atë për Trashëgiminë kulturore. Kreu i legjislativit ka pikasur

edhe shqetësimin që shkaktojnë tek qytetarët e Kosovës deklaratat e herëpashershme të ndonjë përfaqësuesi nga bashkësia ndërkombëtare për mundësitë e shtyrjes së përcaktimit të statusit të vendit.

Ambasadori Uizner, në fjalën e tij para parlamentarëve të Kosovës, ka qenë shumë i qartë dhe i prerë: Do të vazhdojë procesi për përcaktimin e statusit të Kosovës sipas agjendës së Grupit të Kontaktit dhe se SHBA-të angazhohen të mos vonohet zgjidhja e statusit. Ai, ndërkaq, ka kërkuar nga krerët institucionalë dhe politikë të vendit të jenë unikë, jo vetëm tani, por edhe në fazën e parë pas përcaktimit të statusit, sepse, siç është shprehur Uizner, Kosovën e presin sfida të mëdha. “Kosova do të ndihmohet nga bashkësia ndërkombëtare dhe SHBA-të në rrugën e saj drejt ardhmërisë, por institucioneve të Kosovës iu bie përgjegjësia për zhvillimin e vendit”, ka theksuar i

dërguari i posaçëm të SHBA-ve për Kosovë, i cili është shprehur në favor të një sistemi funksional ekonomik të vendit, në raport me ndonjë konferencë donatorësh për Kosovën.

Uizner ka lavdëruar hapat e mirë që janë bërë në Kosovë për plotësimin e standardeve, por ka tërhequr vëmendjen se do të nevojitet punë edhe më e madhe pas përcaktimit të statusit, duke përmendur në mënyrë të veçantë legjislacionin për të drejtat e komunave, të minoriteteve, mbrojtjen e fatoreve etj. Duke iu qasur çështjes së decentralizimit, Uizner ka precizuar se komunat ekzistuese dhe ato që do të krijohen duhet të jenë të afta të mbijetojnë ekonomikisht dhe t'i kontribuojnë zhvillimit të vetë dhe të Kosovës.

Anëtarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare që e kanë marrë fjalën në këtë takim: Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Alush Gashi, Numan Baliq, Mahir Yagcilar dhe Xhezair Murat, ishin unikë për Kosovën e pavarur dhe për kontributin e jashtëzakonshëm të SHBA-ve në rrugën e Kosovës drejtë lirisë dhe përparimit. Të gjithë kanë kërkuar rolin aktiv të SHBA-ve në procesin për Kosovën dhe praninë amerikane në Kosovë edhe pas statusit, duke përfshirë edhe investimet amerikane në ekonominë e vendit tonë. Përfaqësuesit e minoriteteve, ndërkaq, bashkë me mbështetjen për pavarësinë e vendit në afatin sa më të shkurtër, kanë kërkuar edhe garanca për respektimin e të drejtave të minoriteteve.

Parlamentarët e NATO-s vlerësojnë progresin e arritur në vend

*Kryeparlamentari Berisha: Kompromisi është pavarësia e Kosovës
Parlamentarët e Kosovës mbështesin fort zgjidhjen e statusit brenda këtij viti
Baliq kërkon garanci për boshnjakët dhe goranët
Nojkiq kritikon institucionet e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare për projeksionet e
zgjidhjes së çështjes së Kosovës*



Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kolë Berisha bashkë me anëtarët e Kryesisë dhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka pritur sot një delegacion 20 anëtarësh të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, i kryesuar nga Karl Lambers, me të cilin është biseduar për zhvillimet në Kosovë dhe për procesin negociator për zgjidhjen e statusit të vendit. Kryeparlamentari Berisha fillimisht ka falënderuar NATO-n dhe vendet anëtare të saj për gjithçka që kanë bërë për Kosovën dhe popullin e saj, kurse ka shprehur konsiderata për forcat e KFOR-it, të cilat me praninë dhe aktivitetin e tyre ndikojnë pozitivisht në qetësinë dhe stabilitetin në Kosovë, por edhe në rajon. Ai pastaj ka folur gjerësisht për punën e institucioneve të Kosovës për përparimin dhe demokratizimin e vendit, duke u përqendruar sidomos për punën që është bërë për plotësimin e standardeve dhe krijimin e kushteve për jetë të minoriteteve. Duke folur rreth bisedimeve për përcaktimin e statusit, Berisha ka përvijuar qën-

drimin e palëkundur të Grupit Negociator të Kosovës për pavarësinë e vendit. Parlamentarët e NATO-s, të cilët janë në mision të mbledhjes së fakteve për Kosovën, kanë vlerësuar progresin e arritur në vend dhe i kanë dhënë mbështetje procesit paqësor në Kosovë. Kryesuesi i delegacionit parlamentar të NATO-s, Karl Lambers, progresin e arritur e ka quajtur sinjifikativ dhe ka shtuar se Kosova e qetë dhe stabile është faktor stabiliteti në gjithë rajonin. Ai është shprehur se duhet punuar për krijimin e një shoqërie shumëmetnik dhe ka çmuar përkushtimin e palës kosovare për këtë çështje. Parlamentarët e NATO-s kanë theksuar se të gjitha palët duhet të punojnë në përgatitjen e popullatës për të pranuar zgjidhjen për statusin që do ta propozojë kryenegociatori Ahtisari, të cilën e mbështesin plotësisht. Gati të gjithë parlamentarët e Kosovës që e kanë marrë fjalën në këtë takim, kanë këmbëngulur që

zgjidhja e statusit të përfundojë brenda këtij viti.

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Jakup Krasniqi, duke komentuar mundësitë e shtyrjes së zgjidhjes së statusit, për shkak të zgjedhjeve në Serbi, ka pohuar se pikërisht shtyrja e përcaktimit të statusit do t'i forcojë radikalët dhe socialistët e Millosheviqit. Nekibe Kelmendi dhe Gazmend Muhaxheri kanë pohuar se regjimi i Beogradit do të krijojë edhe pretekste të tjera që ta zvarrisë zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Kryeparlamentari Berisha, ndërkaq, ka thënë prerë se shqiptarët e Kosovës janë të gatshëm të jetojnë bashkë me serbët e Kosovës, por kurrë më me Beogradin, pos si fqinjë.

Nga përfaqësuesit e minoriteteve, derisa Mahir Yagcilar, është shprehur i kënaqur me integrimin e minoritetit turk dhe boshnjak në Kosovë, duke lavdëruar zbatimin e gjuhëve të tyre në institucione, në administratë dhe arsim, Numan Baliq ka kërkuar garanci për jetë, punë dhe zhvillim të boshnjakëve dhe goranëve, duke pohuar se kësaj do të mbështesin zgjidhjen të cilën dëshiron shumica e popullsisë së Kosovës. Rangjel Nojkiq, ndërkaq, ka kritikuar institucionet e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare për projeksionet e zgjidhjes së çështjes së Kosovës.

Parlamentarët e Kosovës në takim me parlamentarët e NATO-s, të cilin e kanë vlerësuar të rëndësishëm dhe të dobishëm, kanë ofruar argumente për kornizën ligjore dhe të drejtat e garantuara për minoritetet në Kosovë dhe për përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Kosovës.

Në bisedimet e Vjenës Kosova po luan një rol konstruktiv e kooperues

Krijimi i shtetit të Kosovës nuk do të jetë kërcënim për askënd. Kosova e pavarur do të jetë element stabiliteti në rajon



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, u takua sot me një delegacion 8-anëtarësh, të kryesuar nga **Otto von Habsburg**, pinjoll i dinastisë së Habsburgve dhe anëtar shumë shumë vjeçar i Parlamentit Evropian. Në këtë takim merrnin pjesë edhe anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, si: prof. dr. Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Naim Maloku dhe Mahir Jagxhillar. **Kryeparlamentari Berisha** duke iu drejtuar me fjalë të zgjedhura z. Otto von Habsburg, theksoi se çdo takim me ju shoqërohet nga një kënaqësi e veçantë. "Ju keni dhënë kontribut të veçantë në të gjitha proceset nëpër të cilat ka kaluar e po kalon Kosova, jeni treguar gjithnjë një avokat i palodhshëm i Kosovës, i demokracisë dhe i integriteteve të saj në suaza evropiane. Ish mik i madh i Presidentit të ndjerë Rugova, i cili kishte respekt të madh për ju", u shpreh Berisha.

Në vijim kreu i legjislativit të vendit foli lidhur me zhvillimet aktuale në Kosovë dhe në Parlamentin e vendit, duke u ndalur sidomos në punën që bëhen në fushën e miratimit të ligjeve sipas standardeve evropiane. Parlamenti i Kosovës, tha Berisha,

tashmë ka arritur rezultatet të rëndësishme në aspektin e mbikëqyrjes parlamentare të punës së Qeverisë duke krijuar një mekanizëm llogaridhënës.

Në bisedimet e Vjenës Kosova po luan një rol konstruktiv e kooperues. Krijimi i shtetit të Kosovës nuk do të jetë kërcënim për askënd Kosova e pavarur do të jetë element stabiliteti në rajon. Në këtë frymë ajo angazhohet për marrëdhënie të mira fqinjësorë me të gjitha shtetet e Ballkanit, pra edhe me Serbinë.

Në fillim të fjalës së tij **Otto von Habsburg** shprehu admirimin e tij për personalitetin e Presidentit Rugova. Isha i impresionuar me madhështinë e mendimit të Rugovës, tha Habsburg, ai ishte i përkushtuar për kombin e tij, por edhe për të gjithë qytetarët tjerë që jetojnë në Kosovë. Kosova ka bërë punë të madhe sa i përket pozitës së minoriteteve. Ju po përpiqeni të krijoni diçka të shëndoshë, ndaj si të tillë do të keni vend në tavolinën e demokratëve. Kësaj rruge ju do të keni një mision të rëndësishëm duke dalë si shtet i pavarur në Evropë. Duke ndërtuar marrëdhënie të mira me komunitetet ju keni rast të vlerësoheni si një shembull shumë i mirë

në Rajon dhe Evropë. Në këtë frymë ai u shpreh në mënyrë figurative se nuk është e mirë muzika me një instrument, por ajo që orkestrohet me shumë instrumente. Keni fillim të mbarë, keni udhëheqje të mirë. Pra, të angazhohemi që të jetojmë të gjithë të lirë, sepse kjo është e rëndësishme për të ardhmen. T'i përkushtoheni formimit të shtetit ligjor, tha Habsburg.

Xhavit Haliti tha se në Kosovë nuk ka islamizëm ekstrem, nuk ka nacionalizëm ekstrem, ekzistojnë disa probleme të veçanta, dobësi, të cilat kemi obligim t'i luftojmë me të gjitha mjetet. Kosova evropiane, tha në vijim Haliti, do të ndihmojë shumë në relaksim e rrjedhave në Ballkan, si dhe në të ardhmen e tij të lumtur.

Sabri Hamiti tha se gjendemi para një momenti vendimtar- pavarësisë së Kosovës, ndaj kemi shumë nevojë për ndihmën tuaj që e karakterizon dija e madhe, autoriteti dhe nderi.

Kosova ka investuar dhe ka sakrifikuar shumë që statusi i saj të përfundojë brenda vitit 2006, shih për këtë shtyrja eventuale e përcaktimit të statusit nuk është punë e vogël. Serbia si me çështjen e zgjedhjeve, ashtu edhe me kushtetutën, në preambulën e së cilës e përcakton Kosovën si pjesë të saj, bën përpjekje të orkestruara me anë të një kalendari paralel që të ndikojë në procesin negociator që udhëhiqet nga ana e kryenegociatorit Ahtisari. Në të gjitha këto bashkësia ndërkombe-tare dhe posaçërisht SHBA- të duhet të shohin se nuk është fjala për interesimin e Serbisë për pozitën e serbëve në Kosovë, por ajo është e interesuar për tokën e Kosovës.

Ekspertë nga SHBA-të dhe OSBE-ja shprehin përvojat e tyre për mbrojtjen e dëshmitarëve

Për të krijuar një sistem të suksesshëm në këtë fushë nevojitet besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë dhe në polici

Ekipi i ekspertëve do të hartojë një raport për sigurinë e dëshmitarëve në Kosovë dhe do të japë rekomandimet se si të përmirësohet gjendja në këtë segment të gjyqësisë

Komisioni Parlamentar për Çështje Gjyqësore Legjislacion dhe Kornizë Kushtetues, i kryesuar nga Hydajet Hyseni, kryetar i komisionit, ka pritur sot një ekip të ekspertëve nga SHBA – dhe OSBE-ja për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ka bashkëbiseduar me ta për gjendjen e gjyqësisë në Kosovë, me theks të veçantë mbrojtjen e dëshmitarëve.

Ekspertët nga SHBA-të dhe OSBE-ja, të cilët takuar përfaqësues të institucioneve që lidhen me drejtësinë dhe sigurinë në Kosovë, kanë

ardhur që të vlerësojnë nivelin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Ata do të hartojnë një raport për sigurinë e dëshmitarëve në Kosovë dhe do të japin rekomandimet se si të përmirësohet gjendja në këtë segment të gjyqësisë.

Nga takimi ka rezultuar se për të krijuar një sistem të mbrojtjes së dëshmitarëve nevojitet besimi i qytetarëve në institucionet e drejtësisë dhe në polici. Ndërkaq është thënë se për të pasur sukses në mbrojtjen e dëshmitarëve, pos rregullativës ligjore nevojitet vendosmëria e qev-

erisë për ta luftuar krimin.

Anëtarët e Komisionit legjislativ kanë spikatur se Kosova ka kapacitete për të vendosur sundimin e ligjit, por kanë theksuar se shumë kompetenca në lëmin e gjyqësisë janë të rezervuara dhe se ato shumë ngadalë po barten tek institucionet vendëse. Mu për shkak të kompetencave të rezervuara është bllokuar Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, kanë thënë deputetët këtij komisioni, të cilët kanë kërkuar ndihmën e ekspertëve që ligji në fjalë të zhblokohet.

GJENDJA AKTUALE NË KOMBINATIN “TREPÇA”

Nga gjiganti me gjithsej 22.000 të punësuar, sot mezi që punojnë 2.000 sish

Ndonëse kombinati “Trepça”, për nga resurset natyrore, është një ndër katër kombinatat më të pasur në botë, sot ai nuk është duke funksionuar. Nga gjiganti me gjithsej 22.000 të punësuar, sot mezi që punojnë 2.000 sish. Në të vërtetë, tash e dy muaj, në kombinatin “Trepça” nuk është duke u punuar, qoftë për shkak të shkaqeve objektive, po ashtu edhe për arsye subjektive, edhe pse gjatë periudhës së kaluar gjithsej katër xeherore janë aftësuar për eksploatinim e pasurive natyrore nga këto xeherore. Janë këto vetëm disa nga konstatimet nga mbledhja e rregullt e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion të Kuvendit të Kosovës, që e kryesoi z.

Ibush Jonuzi, kryetar i Komisionit, në të cilën pikë e vetme e rendit të ditës ishte gjendja aktuale në kombinatin “Trepça”. Në këtë mbledhje, përveç anëtarëve të Komisionit, morën pjesë edhe përfaqësuesit e kombinatit “Trepça”, të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe përfaqësuesit nga shtylla IV e UNMIK-ut.

Në mbledhjen e theksuar, ndër të tjera, u tha që kombinati “Trepça”, ndaj investitorëve të jashtëm ka borxh ndërmjet 75-220 milion €, (që në të shumtën e rasteve është krijuar në periudhën 1990-1999), që paraqet një barrë shtesë për punë dhe prodhimtari të rregullt në këtë kombinat. Kur flitet për problemet e këtij kombinati, duhet të theksohet që përkujdesja ndaj punëtorëve që kanë mbetur pa punë viteve

të 90-ta, përkatësisht pagesa e mjeteve në para në emër të ndihmës sociale për ta, fuqia punëtore relativisht e moshuar (ka mjaft punëtorë që janë të moshës ndërmjet 55 dhe 60 vjeç), si dhe ndotja e ambientit nga puna e kombinatit, janë ndër problemet shtesë.

Në mbledhjen në fjalë të Komisionit, duke folur për daljen nga kjo situatë e pavolitshme, u tha që në botë ka mjaft të interesuar për blerjen e këtij kombinati, e po ashtu ka edhe të tillë që janë të interesuar për të investuar në zhvillimin e këtij gjiganti të ekonomisë kosovare. Por, siç u dëgjua disa herë nga pjesëmarrësit e mbledhjes, duhet që sa më parë të përcaktohet statusi i këtij gjiganti, në mënyrë që të fillojë puna e rregullt në këtë kombinat.

Pastrimi i parave është një materie komplekse me dimensione globale

Kosova, ku pastrimi i parave përbën një praktikë të re, ka nevojë për një ligj të fuqishëm, me anë të të cilit do të hetohet, parandalohet e luftohet çdo veprim kriminal në lëmin e pastrimit të parave. Luftën kundër pastrimit të parave duhet ta udhëheqin institucionet vendore të Kosovës, gjë që konkretisht duhet të rezultojë në kalimin e Qendrës për Hetime Financiare, që tani vepron në kuadër të UNMIK-ut, nën përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës

Në ambientet e Kuvendit të Kosovës sot u mbajt një tryezë e rumbullakët lidhur me pengimin e pastrimit të parave dhe veprave penale që ndër-lidhen me të, organizuar nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa, Qendra Informativ Financiare e UNMIK-ut dhe Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Debati është organizuar në shenjë të përgatitjeve për fillimin e amendamentimit të Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave, i cili tashmë është aprovuar në parim nga ana e Kuvendit të Kosovës. Në këtë frymë, qëllim parësor i tryezës ishte diskutimi e njohja me praktikën më të avancuar ndërkombëtare për parandalimin e shpëlarjes së parave. Në këtë takim merrnin pjesë edhe znjsh. Linda Samuel, zëvendës shefe e Seksionit për Konfiskimin e Pasurisë dhe Shpëlarjen e Parave në Divizionin e Kriminalistikës të Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, drejtori i Qendrës Informativ Financiare, Kevin Stephenson dhe këshilltarja juridike e Zyrës Amerikane në Prishtinë, Sarah Lum, të cilët dhanë një ndihmesë të madhe në shqyrtimin e kësaj teme, duke përvijuar përvoja të çmueshme të luftimit të pastrimit të parave, si në aspektin ligjor, ashtu edhe në praktikë, posaçërisht duke u mbështetur në përvojat amerikane në këtë segment. Në këtë vështrim u tha se edhe Kosova, ku pastrimi i parave përbën



një praktikë të re, ka nevojë për një ligj të fuqishëm, me anë të të cilit do të hetohet, parandalohet e luftohet çdo veprim kriminal në lëmin e pastrimit të parave. Pastrimi i parave është një materie komplekse, me dimensione globale, ndaj për luftimin e tij duhet të angazhohen një vistër e gjerë institucionesh.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, me këtë rast tha se rrezikut nga përfshirja në procesin e pastrimit të parave i nënshtrohen të gjitha segmentet e shoqërisë, përfshirë këtu bizneset, qofshin ato të vogla, të mesme apo edhe multinacionale, mediat, administrata, gjykatat, policia, si dhe vetë politika. Nga kjo del se luftimi i pastrimit të parave është problem i çdo shoqërie, pra edhe i shoqërisë kosovare.

Dihet mirë se Kosova është në rrugë e sipër që në të ardhmen e afërt të pranohet si shtet i pavarur dhe me këtë të bëhet anëtare e plotë e bashkësisë ndërkombëtare. Me çdo kusht nuk duhet lejuar që Kosova të bëhet një vend i përshtatshëm për pastrimin e parave. Nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që në hapat e parë të

shtetit të sapoformuar Kosova të dështojë në përmbyshjen e detyrimeve që i ka si anëtare e bashkësisë ndërkombëtare dhe të krijohet përshtypja se Kosova nuk mund të jetë partner i besueshëm në luftën e botës së civilizuar kundër kimit të organizuar dhe terrorizmit. Përveç kësaj, nuk mund të lejohet, që paratë e

ndyta të kenë ndikim në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Sepse ky, jo vetëm që do të ishte një zhvillim jetëshkurtër, por që në fillim themelet juridike dhe morale të shtetit dhe të shoqërisë kosovare do të tronditeshin, ndoshta edhe në përmasa të pariparueshme.

Në vijim Naser Osmani tha se luftën kundër pastrimit të parave duhet ta udhëheqin institucionet vendore të Kosovës, gjë që konkretisht duhet të rezultojë në kalimin e Qendrës për Hetime Financiare, që tani vepron në kuadër të UNMIK-ut, nën përgjegjësinë e Qeverisë së Kosovës.

Duke folur rreth faktit se në kuadër të cilës ministri, ose institucioni tjetër të vendit, do të vepronte njësisht, ose Shërbimi për luftimin e pastrimit të parave, diskutuesit ishin unik në konstatimin se gjëja kryesore në këtë aspekt do të ishte që, si nga ana ligjore, ashtu edhe nga ana praktike, të gjenden zgjidhje që do të ofronin pavarësi të plote të punës së këtij shërbimi, pra jashtë çdo ndikimi, sepse nëse veprohet ndryshe, atëherë nuk do të ketë asgjë në betejën e luftimit të pastrimit të parave.

Misioni i BE-së nuk do të jetë substitut i UNMIK-ut

I dërguari special i Solanës për përgatitjen e Misionit të BE-së në Kosovë, Torbjorn Solhstrom shprehet se misioni do të jetë i kufizuar në kompetenca dhe në kohë

BE-ja nuk dëshiron ta administrojë Kosovën, por ta ndihmojë atë në rrugën e zhvillimit dhe të përparimit drejt anëtarësimit në BE

Misioni do ta ketë zyrën ndërkombëtare-civile, do të ketë autorizime të mbikëqyrë policinë dhe drejtësinë, madje edhe të ndërvejojë në emërimin e kuadrove

Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euro-Atlantik, në mbledhjen e drejtuar nga Sabri Hamiti, kryetar i komisionit, ka shqyrtuar sot çështjen e pranisë ndërkombëtare në Kosovë pas statusit, kurse për t'u sqaruar më mirë për çështjen ka ftuar të dërguarin special të Solanës për përgatitjen e Misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë, z. Torbjorn Solhstrom. Fillimisht Hamiti ka shprehur qëndrimin e pranueshëm nga institucionet dhe populli i Kosovës për një prani të lehtë ndërkombëtare në Kosovë edhe pas përcaktimit të statusit dhe ka shtruar një varg pyetjesh për cilësinë, kapacitetin dhe kohëzgjatjen e Misionit të BE-së në Kosovë, duke insistuar që një mision i tillë të bëhet në marrëveshje me institucionet e vendit, në mënyrë që të perceptohet mirë edhe nga populli i Kosovës.

I dërguari special i kryediplomatit evropian për përgatitjen e Misionit të BE-së në Kosovë, Torbjorn Solhstrom, ka sqaruar se prania e ndërkombëtare në Kosovën e passtatusit do të jetë civile dhe ushtarake. Sa i përket pranisë civile, Solhstrom ka thënë se Misioni i ardhshëm i BE-së do të jetë i kufizuar në kompetenca dhe në kohë dhe se ai nuk do të jetë substitut i UNMIK-ut. Ai është shprehur i prerë se BE-ja nuk dëshiron ta administrojë Kosovën, por ta ndihmojë atë në rrugën e zhvillimit dhe të përparimit drejt anëtarësimit në BE dhe se këtë do ta bëjë në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, sidomos me SHBA-të.

Misioni do ta ketë zyrën ndërkombëtare-civile, ka thënë përfaqësuesi i



Solanës në Kosovë dhe do të fokusohet në mbështetjen e reformave strukturore në Kosovë (siç është vepruar në Maqedoni dhe Kroaci) dhe që institucionet e Kosovës të ndihmohen të merren me sfidat specifike të vendit. Për shkak të përvojës së paktë të institucioneve dhe mosbesimit ndëretnik që mbretëron në Kosovë, Misioni do të ketë autorizime të mbikëqyrë realizimin e decentralizimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore, fushën e sundimit të ligjit dhe çështjet e sigurisë, madje edhe të ndërvejojë në emërimin e kuadrove.

Anëtarët e Komisionit kanë qenë shumë aktiv në këtë takim dhe me pyetjet dhe sugjerimet e tyre kanë kontribuar për një qasje shumë realiste për Misionin e BE-së në Kosovë. Ata kanë kërkuar mbështetje më të madhe për zhvillimin e përsheptuar ekonomik të Kosovës, asistencë më të sofistikuar teknike, në funksion të aftësimit të kuadrit vendës, rishikimin në intervale kohore të këtij misioni, raportet e koekzistimit për një kohë të Misionit

të BE-së dhe të UNMIK-ut etj. Solhstrom është përgjigjur se shumëçka do të varët nga cilësia e statusit të Kosovës, por është shprehur i bindur se sidoqoftë Kosova duhet të ketë bashkëpunim me BE-në dhe me mekanizmat financiarë ndërkombëtarë, se duhet të mbahet një konferencë donatorësh për aktivizimin e resurseve ekonomike të Kosovës. Ai ka pohuar se Kosova gradualisht duhet t'i plotësojë kushtet e Kopenhagës për anëtarësim në BE. Duke sqaruar, ndërkaq, për raportet me UNMIK-un, në fazën tranzitore, para se ai ta përmbyllë misionin në Kosovë, Solhstrom ka thënë se atëherë shumica e kompetencave të UNMIK-ut do t'u kalohen institucioneve të vendit, kurse disa sosh Misionit të BE-së në Kosovë.

Anëtarët e Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar i kanë vlerësuar të rëndësishme takimet e tilla dhe kanë pohuar se çfarëdo marrëveshje lidhur me Kosovën duhet ta marrë mbështetjen e Kuvendit të Kosovës.

KUVENDI I KOSOVËS NË SEANCËN
E MBAJTUR MË 19 TETOR 2006,
NXORI KËTË:

DEKLARATË

Kuvendi i Kosovës dënon vendosjen e Kosovës në preambulën e Kushtetutës së ardhshme të Serbisë, si dhe organizimin e referendumit në territorin e Kosovës

1. Kuvendi i Kosovës veprimin e shtetit Serb e konsideron agresion kushtetues ndaj Kosovës.
2. Kuvendi i Kosovës pret nga grupi i Kontaktit dhe BE-ja që aktin e Serbisë ta vlerësojnë si veprim të njëanshëm, i cili nuk do të ketë ndikim në statusin politik të Kosovës.
3. Referendumi i Serbisë në Kosovë është ilegal për Kosovën prandaj nuk do të ketë efekte juridike. Mbajtja e referendumit të Serbisë në Kosovë reflekton pasiguri tek qytetarët e Kosovës. I ftojme qytetarët serb të Kosovës të integrohen në jetën qytetare, politike, publike e institucionale.
4. Kuvendi i Kosovës është i bindur se argumenti për shtyrjen eventuale të njohjes së pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës është i pa qëndrueshëm dhe mund t'i ndërlikojë proceset demokratike në Kosovë dhe në rajon. Populli i Kosovës është Sovran dhe duhet të vendos për fatin e tij.

**KUVENDI I KOSOVËS, NË
SEANCËN PLENARE TË DATËS 21
SHTATOR 2006, LIDHUR ME
SHPËRTHIMET E FUNDIT NË
KOSOVË, LËSHON KËTË**

DEKLARATË

Kuvendi i Kosovës dënon me forcë shpërthimet e ditëve të fundit në Gjilan, në Ferizaj e në Klinë, duke i konsideruar akte dhune e terrori që rrezikojnë jetën e njerëzve dhe krijojnë pasiguri në vend, Kuvendi i Kosovës kërkon nga SHPK-ja , nga Policia e UNMIK-ut dhe nga përgjegjësit e tjerë të sigurisë në Kosovë, që kryesit e këtyre akteve të dhunës e të terrorit të nxirren para ligjit si dhe të parandalojnë veprimet që rrezikojnë sigurinë e qytetarëve të Kosovës,

Kuvendi i Kosovës vlerëson që aktet e dhunës dhe të terrorit prishin pamjen e Kosovës para botës dhe dëmtojnë rëndë politikisht procesin e pavarësisimit të Kosovës.

Komunikimi kulturor ndihmon Kosovën në ecjen drejt Evropës

*Mirënjohje për kontributin e Norvegjisë dhënë
Kosovës para, gjatë dhe pas luftës*



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, kishte sot një takim me një delegacion të institucioneve ta larta të Norvegjisë, kryesisht nga lëmi i botimit dhe përkthimit të teksteve shkollore në përbërje : Toril Langlete (Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë së Norvegjisë), Sverre Johan Kvale (shef i Zyrës Norvegjeze në Prishtinë), Astrid Megard Sollid (udhëheqëse e projektit të Venstres Oppsyningsforbund), Erik Solvberg (shkrimtar) dhe Ingvild Ronning Radwan (gazetar i gazetës "Tronder-Avisa") . Delegacionin e shoqëronte dhe drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, prof. dr. Sali Bashota.

Drejtuesit e delegacionit e njoftuan kryeparlamentarin Berisha me aktivitetet e deritashme sa i përket furnizimit të shkollave në Kosovë me tituj specifik të karakterit pedagogjik, duke theksuar se tekstet e autorëve të njohur norvegjezë po mirëpritën në Kosovë. Në këtë frymë ata prem-

tuan se kjo veprimtari do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Kryeparlamentari Berisha falënderoi delegacionin për këtë ndihmë që po i ofrohet arsimit e kulturës së vendit tonë dhe njëkohësisht shprehu mirënjohje për kontributin e Norvegjisë që i ka dhënë Kosovës para, gjatë dhe pas luftës. Në vijim kreu i legjislavit prezantoi edhe një histori të shkurtër të vështirësive që ka pasur Kosova në rrugën e dijes dhe edukimit për shkak të presioneve dhe të censurës. Në dritën e kushteve të reja të krijuara tani në vend, kryeparlamentari Berisha theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi me vendet evropiane në këtë fushë shumë të rëndësishme, e në këtë kuadër edhe me Norvegjinë. Kosova ka synim jetik integrimet evropiane, ndaj bashkëpunimi dhe komunikimi kulturor edhe në këto forma që zhvillohen ndihmojnë Kosovën në ecjen drejt Evropës, pohoi kryeparlamentari Berisha.

Prona private nuk është vetëm në funksion të individit

Prona private gëzon mbrojtjen më të lartë juridike, mirëpo, në anën tjetër, ajo nuk mund të trajtohet e izoluar nga nevojat e shoqërisë dhe të jetë e paprekshme, edhe atëherë kur shfrytëzimi i saj kërkohet për interes publik



Në seancën e 31 gushtit të këtij viti, Kuvendi i Kosovës shqyrtoi për herë të parë Projektligjin për shpronësimin me interes publik. Fjalën hyrëse mbi këtë Projektligj e paraqiti Ibush Jonuzi, kryetar i Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion. Ky Komision, tha ai, e ka filluar procedurën e hartimit të Projektligjit për shpronësimet me interes publik, ndërsa nisma legjislative është e Kuvendit dhe si e tillë është në paj-

tim me kreun 9.3.34 të Kornizës Kushtetuese.

Projektligji mbështetet në legjislacion të avancuar evropian

Prona private nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut, por ajo duhet të konsiderohet edhe si njëri prej elementeve kryesore që e mundëson krijimin dhe zhvillimin e një shoqërie të lirë dhe të orientuar drejt ekonomisë së tregut. Si e tillë pronë private gëzon mbrojtjen më të

lartë juridike. Mirëpo, në anën tjetër pronë private nuk mund të trajtohet e izoluar nga nevojat e shoqërisë dhe të jetë e paprekshme, edhe atëherë kur shfrytëzimi i saj kërkohet për interes publik. Pronë private nuk është vetëm në funksion të individit, përkatësisht pronarit privat, por është edhe në funksion të shoqërisë dhe të interesit të saj të përgjithshëm. Mundësia ligjore për ta shpronësuar pronën e paluajtshme private është më se e rëndësishme për funksionimin e një shoqërie. Shumë projekte të zhvillimit urbanistik, të rregullim-

it hapësinor dhe të ndërtimit të infrastrukturës publike, si p.sh. ndërtimi i rrugëve dhe magjistrave, minierave dhe termocentraleve nuk mund të realizohen nëse nuk do të ekzistonte kjo mundësi ligjore. Mirëpo, edhe në ato raste kur prona private kërkohet edhe në shërbim të interesit të përgjithshëm, pronari privat duhet të ketë mundësi për mbrojtje të mjaftueshme juridike dhe të kompensohet për humbjen e së drejtës së tij të pronësisë. Shikuar nga ky kënd gjetja e balancës midis interesave të pronarit privat dhe të atyre të shoqërisë, ofrimi i procedurave transparente dhe efektive, si dhe përcaktimi i kompensimit të drejtë janë qëllime kryesore të një ligji për shpronësimet. Lëmi i shpronësimeve tani për tani është i rregulluar me ligjin për eksproprijim, një ligj i viteve të 80-ta. Edhe pse formalisht ligji i aplikueshëm, ai nuk i përshatet zhvillimeve moderne dhe situatës në të cilën gjendet sot Kosova. Projektligji për shpronësimet në interes publik synon të ofrojë një rregullim juridik modern të kësaj fushe, duke qenë në pajtim të plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Projektligji i cili është përgatitur nga grupi punues, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë juridik të zyre së kryeministrit dhe USAID-it, bazohet në modelet e legjislacionit të Gjermanisë, të shteteve baltike dhe të Shqipërisë, modele këto të hartuara në vitet e fundit, të cilat pasqyrojnë zhvillimet moderne në këtë fushë. Projektligji siguron pajtueshmërinë e plotë me konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, duke kërkuar shprehimisht që ligji të interpretohet në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente. Gjatë fazës së hartimit, po ashtu është mbajtur një dëgjim publik, në të cilin Projektligji si i tillë është mirëpritur nga pjesëmarrësit. Për nga përmbajtja e tij Projektligji përcakton kushtet të cilat lejojnë shpronësimin e pronës së paluajtshme private si dhe rregullon punët përgatitore që mund të kryhen para se të fillojë procedura e shpronësimit.

Mundësi për eliminimin e shumë probleme në praktikën gjyqësore

Nergjivane Dauti, tha se Projektligji plotëson një zbrazësi juridike të konsiderueshme, ashtu që krijon një infrastrukturë ligjore të domoshme të harmonizuar me konventat ndërkombëtare relevante, që mundësojnë eksproprijimin apo shpronësimin e pronës private të paluajtshme për interesin e gjerë publik, vetëm në ato raste kur ky interes publik nuk mund të realizohet në ndonjë formë tjetër adekuate ligjore.

Është i padiskutueshëm fakti se ky ligj është i një rëndësie të veçantë, por do të ishte shumë me rëndësi që në Kuvend të miratonim ligje tjera me rëndësi edhe më vitale për Kosovën, për zhvillimin e saj ekonomik dhe shoqëror, siç është Ligji për pronën, apo Ligji për denacionalizimin, që së bashku me këtë Ligj që tani po e shqyrtojmë do të përbënin një bazë të fortë ligjore me anë të së cilës do të eliminoheshin shumë probleme në praktikën gjyqësore, do të zgjidheshin shumë konflikte të rënda pronësore, të cilat shumë shpesh përfundojnë me vrasje dhe vepra tjera të rënda penale.

Me këtë ligj përcaktohen rregullat lidhur me kushtet që lejojnë shpronësimin e pronës private për hir të interesit publik, procedurën e shpronësimit, përdorimin e pronës private për interesim publik, si dhe kompensimin lidhur me shpronësim. Duke paraqitur disa vërejtje deputetja Dauti tha se nenet 1, 4 dhe 5 duhet të riformulohen në tërësi.

Vërejtja tjetër thelbësore, ka të bëjë me nenin 19. Ligji i mungon shtylla e bazë e qëndrueshmërisë për t'u zbatuar me lehtësi në praktikë. Kompensimi për shpronësimin e një paluajtshmerie duhet të jetë i drejtë, por nuk mund të jetë më i lartë se vlera e saj e tregut. Shpërblimi i drejtë për eksproprijim përmendet vetëm në nenin 19 të Ligjit, pa u definuar dhe precizuar në mënyrë komplete. Pjesëmarrësit në këtë pro-

cedurë duhet të veprojnë në bazë të dispozitave imperative apo JUS KOGENS. Mirëpo, zbatimi i rreptë i ligjit nuk duket të shkaktojë padrejtësi. Në këtë drejtim vjen në shprehje sentenca latine "SUMMUM JUS, SUMMUM INIURIA" që do të thotë respekt ligjit, por në suazat normale të sistemit juridik.

Shpërblimi i drejtë duhet të jetë i atillë që të sigurojë për pronarin e mëparshëm pozitë të barabartë sociale dhe ekonomike, ashtu siç e ka pasur para eksproprijimit. Shpërblimi i drejtë duhet të sillt në lartësinë, e cila do t'i mundësonte pronarit të fitojë tokë bujqësore sipas madhësisë, bonitetit dhe kulturës, së paku përafërsisht të barabartë sikur toka që është eksproprijuar. Kjo do të thotë se shpërblimi për paluajtshmerinë e eksproprijuar duhet të jetë i atillë që t'i mundësojë pronarit të më parëm t'i sigurojë kushtet e jetës dhe të punës të cilat i ka pasur para eksproprijimit.

Shpërblimi i drejtë nuk duhet të jetë më i vogël nga çmimi i tregut apo çmimet në bazë të të cilit pronari i paluajtshmerisë në kushtet e tilla do të kishte mundësi të blejë paluajtshmerinë e cila do t'i përgjigjej asaj e cila eksproprijohet.

E gjithë kjo bëhet me qëllim që ekzistenca materiale e pronarit të mëparshëm dhe anëtarëve të familjes të mos iu cenohet dhe vetë eksproprijimi mos të marrë karakter të dhunës ekonomike.

Kriteret të cilat merren parasysh për caktimin e lartësisë së shpërblimit të drejtë për eksproprijim janë: vlera e tregut të paluajtshmerisë, kushtet personale të pronarit, kohëzgjatja e eksproprijimit, llojet e objekteve të eksproprijimit, lartësia e kamatës në shpërblim nëse caktohet shuma në të holla. Nergjivane Dauti dha disa vërejtje edhe rreth neneve 23,35,38,42,43 dhe 44.

Gjylnaze Sylja në fillim shtroi pyetjen, se a thua fjala shpronësim është fjalë adekuate për t'u përdorur në këtë Projektligj. Këtë po e theksoj, tha ajo për arsye se ky term është term negativ, i cili mund të nxisë

kujtesën e hidhur të qytetarëve të Kosovës, të cilët në faza të ndryshme të historisë, dhe sidomos në kohën e regjimit komunistë, janë shpronësuar për motive politike. Pra duhet të zgjidhet një term tjetër që do të ishte më adekuat. Qëllimi i këtij Projektligji është i qartë, të ofrojë bazën ligjore për marrjen e pronës private nisur nga qëllimi më i lartë publik, nëse ky qëllim nuk mund të realizohet ndryshe. Ky veprim i shtetit është legjitim nëse i përmbahet parimit të kompensimit adekuat dhe zbatimit të interesit publik të kualifikuar, që do të thotë se shpronësimi bëhet vetëm në rastet kur një zgjidhje tjetër për realizimin e interesit publik nuk mund të arrihet ndryshe dhe kjo është inkorporuar në ligj.

Kamuflohen edhe interesa private në emër të interesit publik

“Ky Projektligj është e vërtetë që ka të bëjë me shpronësimet për interesin publik, po këtu janë kamufliuar edhe interesat private në emër të interesit publik, sepse askush nga ne këtu që jemi në këtë sallë nuk mund të ketë diçka kundër ndërtimit të projekteve të rëndësishme me interes publik, mirëpo jo në të gjitha rastet ky ligj e parasheh që shpronësimet mund të jenë për atë qëllim. Ka edhe shpronësime të cilat janë me karakter të pastër privat. Tek neni 4 saktësohet se shpronësimi është në interesin publik dhe mbizotëron mbi interesin privat, nëse veprimtaria për realizimin e së cilës kërkohet shpronësimi mbulohet nga plani urbanistik i përgatitur me dispozitat ligjore përkatëse. Pra në mungesë planit urbanistik interesin publik dhe mbizotërimin e interesave private e përcakton Qeveria e Kosovës me vendim të posaçëm në pajtim me dispozitat e këtij Ligji”, u shpreh Nazim Jashari.

Nuk mundet Qeveria e Kosovës ta determinojë interesin publik, tha Nazim Jashari, pa e marrë parasysh mendimin komunave ku duhet të

bëhet shpronësimi. Kuvendet komunale nëpër ato vende ku duhet të organizohet një veprimtari publike, ose të ndërtohet një projekt publik duhet të shprehin mendimet e tyre përmes asambleve komunale, mirëpo këto asamble komunale absolutisht nuk janë marrë në konsideratë.

“Do të ndalem pak te aspekti i kamuflimit të interesit privat në këtë Projektligj. Unë e thashë më herët që në mungesë të planit urbanistik interesin publik dhe mbizotërimin e tij ndaj interesave private e përcakton Qeveria e Kosovës. Pika e pestë thotë se supozohet se interesi publik mbizotëron mbi interesin privat nëse shpronësimi ka për qëllim, ndërtimin dhe zgjerimin e objekteve që u nevojitet organeve publike, sigurisht ndërtimin e objekteve për prodhimin, furnizimin ose distribuimin e energjisë.

Objektet për furnizimin dhe distribuimin e energjisë janë me interes, por objektet për prodhimin e energjisë nuk janë në interes publik, janë me interes të pastër privat, ose mund të jenë me interes privat, për deri sa të mund të jenë me interes privat ne duhet saktë ta definojmë këtë interes, edhe ky ligj duhet të pozicionohet ndaj këtij interesi, sepse mendoj se në këtë rast po krijohet një situatë paradoksale, ku përmes interesit publik, po shitet interesi privat... Cili është interesi publik për funksionimin e Ferroniklit aktualisht në Drenas, në qoftë se Ferronikli ka nevojë të shpronësojë prona të reja edhe i duhen prona të reja për të arritur efektivitetin dhe prodhimtarinë e tij... Sepse thjeshtë, me rritjen e mundësive për shtim të prodhimtarisë rritet interesi i pronarit, tash aktualisht Alferonit, prandaj mendoj se kur e thashë kamuflimin e interesave private përmes një ligji për shpronësimin me interes publik këtu e keni shembullin markant se si mund të ndodhë”, tha Jashari.

Nuk mund të jetë ministria ajo që, edhe shpronëson, edhe e cakton kompensimin

Nekibe Kelmendi duke bërë disa vërejtje në tekstin e Projektligjit propozoi që nga titulli i Projektligjit të hiqet fjala eksproprijim. Ndërkaq, në Nenin 2 të përcaktohet edhe të jepet edhe përkufizimi se çka do të thotë interes publik.

Në Nenin 3, fjala: “supsidiar “ nuk përdoret me vend, në vend të kësaj fjale duhet të përdoret termi “përshatshmërisht”. Në nenin 6, te punët përgatitore duhet te jetë edhe paraqitja e dokumentit bankar, se përfituesi i shpronësimit i ka të siguruar mjetet për kompensimin real për tokën, paluajtëshmërinë, apo të mbjellat dhe frutat tjera të cilat shpronësohen dhe kompensohen.

Në Nenin 8, paragrafi 2, në vend të fjalës: “mund të kërkoj”, duhet të përdoret fjala: “imperative”, ndërsa para nenit 11 duhet të ndërhyhet me një dispozitë të re në të cilën duhet të thuhet se: paraprakisht duhet të përfundojë procedura e konstatimit apo e caktimit të interesit publik e mandej të nisët procedura e shpronësimit.

Neni 13, paragrafi 4, është normë udhëzuese, sipas të cilit kundër vendimit mund të ushtrohet padi sipas nenit 50 të këtij Ligji, ndërkaq neni 50 fare nuk bën fjalë për padi, krejt tjetër çështje rregullon neni 50. Te Neni 15, paragrafi 1, duhet të shtohet teksti “që pasi të marrë formën e prerë vendimi mbi shpronësimin, mund të bëhen ndryshimet në kadastër dhe përfituesi i shfrytëzimit mund të bëhet pronar i ri i paluajtëshmërisë e cila është objekt shpronësimi.

Neni 19 është shumë i paqartë dhe duhet patjetër të qartësohet, sepse me të më shumë favorizohet përfituesi sesa ish-pronari, e qëllimi i këtij ligji nuk është që pronari të dëmtohet, por të jetë i kënaqur me kompensimin. Në të kundërtën, atij i mohohet një e drejtë e cila është e garantuar me nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat Njeriut.

Neni 21 duhet të reduktohet, ndërkaq kur është fjala për Nenin 23, Kelmendi shprehu mendimin se në rast se ekziston kontrata mbi qiradhënie dhe qiramarrje midis ish-pronarit dhe personit të tretë, nuk do të ishte dashur që personi i tretë automatikisht të hidhet në rrugë, së paku deri sa të sigurojë ai vetë një strehim, duhet t'i jepet një kohë e përshtatshme për të gjetur strehimin e tij e jo të hidhet menjëherë në rrugë.

Nuk mund të jetë ministria ajo që, edhe shpronëson, edhe e cakton kompensimin

Në Nenin 31 thuhet: "Ministria e vlerëson paluajtshmërinë dhe cakton shumën e kompensimit", pra prapë është caktimi i kompensimit në mënyrë administrative. Nuk mund të caktohet kështu, ka mbaruar ajo kohë kur komuna ka nxjerrë vendim dhe të ka thënë 01% e çmimit të tregut caktohet për kompensim dhe nuk ke nga del jashtë atij çmimi, tash jemi në ekonomi të tregut, nuk jemi në ekonomi administrative, prandaj nuk mund të jetë ministria ajo që, edhe shpronëson, edhe e cakton kompensimin. Kjo natyrisht është në kundërshtim me Nenin 19, paragrafi 1, ku thuhet se kompensim real është

çmimi i tregut.

Edhe nenet pasuese i rregullojnë procedurat e kompensimit, por ato në vazhdimësi janë në kundërthënie me nenet paraprake.

Neni 45, duhet ta rregullojë çështjen e shpronësimit të përkohshëm, jo të përdorimit të përkohshëm. Përdorimi i përkohshëm dallon prej shpronësimit të përkohshëm, dhe duhet të mundësohet edhe hyrja në posedim në rastet emergjente, edhe para marrjes së formës së prerë të aktvendimit mbi shpronësimin në rastet e caktuara me ligj, që do të rregullohen këtu, por me amendamente.

Gani Koci tha se terminologjia e përdorur në këtë Projektligj nuk është adekuate me materien që dëshiron ta rregullojë. Në këtë vështrim ai përmendi termin pronë sunduese, duke shtruar pyetjen se çka nënkuptohet me këtë. Ka pronë në disponim, në shfrytëzim, në pronësi etj. etj. por, pronë sunduese, kjo nuk haset në terminologjinë ose në literaturën juridike. Në anën tjetër, këtij Projektligji i mungon një kapitull, që është kapitulli më i rëndësishëm i ligjit, është caktimi i interesit të përgjithshëm, mënyra e caktimit të interesit të përgjithshëm dhe subjektet që caktojnë interesin e përgjithshëm. Ky interes i

përgjithshëm sikur është shkapërderdhur në shumë paragrafë, në shumë nene që nuk janë të qarta, prandaj duhej që të ishte një kapitull i veçantë.

Në anën tjetër, absolutisht nuk përmendet mënyra e krijimit të fondeve lidhur me kompensimin për shpronësimin me interes publik. Kryhet shpronësimi dhe tek pastaj fillon procedura e kompensimit e ku ta di unë, ndërsa ligji do të duhej të përcaktojë së pari kompensimin dhe pastaj hyrjen në posedim e cila është objekt i shpronësimit. Këto dhe çështjet tjera, që u thanë këtu konsideroj se do të mund të rregulloheshin vetëm në qoftë se refuzohet në parim miratimi i këtij Projektligji dhe i kthehet sponzoruesit edhe një herë në rishqyrtim.

Pjesa dërrmuese e diskutimeve lidhur me Projektligjin përshkohej nga një qasje konstruktive, përkatësisht nga angazhimi për të sjellë një ligj sa më të përkryer për këtë fushë aq të rëndësishme, ndaj edhe u përkrah në parim nga Kuvendi. Në këtë frymë u përkrah edhe propozimi që në procesin e amendamentimit të angazhohen ekspertë eminentë të këtij lëmi, si nga brenda ashtu edhe jashtë Kuvendi.

DELEGACIONI I GRAVE NGA SHQIPËRIA NË VIZITË DYDITËSHE NË PRISHTINË

Këmbim përvojash lidhur me kuotimin gjinor

Një grup grash nga Shqipëria kanë arritur në një vizitë dyditëshe në Prishtinë. Qëllimi i kësaj vizite është këmbimi i përvojave lidhur me kuotimin gjinor. Në përbërje të këtij delegacioni janë Tatjana Parlloku, ndihmëse e Presidentit të Shqipërisë, Drita Teta, koordinatore e programit "Gratë mund t'ia arrijnë", Xhulieta Jaho, kryetare e Gruas Republikane, Zhaneta Harka,



kryetare e Gruas Socialdemokrate, si dhe përfaqësuese tjera nga subjektet

politike dhe nga Lëvizja e gruas. Ky aktivitet realizohet sipas programit "Gratë mund t'ia arrijnë", i financuar nga Qeveria e Norvegjisë, në kuadër të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore. Gjatë vizitës u realizuan disa takime me gratë parlamentare nga Kosova, me përfaqësuese të Qeverisë që kanë të bëjnë me probleme gjinore, si dhe me përfaqësuese të shoqërisë civile.

